

POSSIBILITIES FOR PARTNERS

Smart marketing.
Real impact.

+383 43 899 331 | www.pfp-ks.com

DAR 333 999

Mirë se erdhe në Kosovë.
Udhëtimi yt fillon me HEJ.

TRAVEL MAGAZINE

SHKURT - MARS 2026

GP MAGAZINE

AIRPLANE MAGAZINE

18 VJET PAVARËSI:

Rritemi, forcohemi dhe njihemi

REKOMANDIMI YNË

Vizitojeni Lin në Pogradec

20 VENDET

më të mira për të udhëtuar në vitin 2026

INTERVISTË AHMET ISMAILI GUVERNATOR BQK

Sistemi bankar i Kosovës, rritje kursimesh dhe investimesh

ËNDËRRAT DHE MUNDËSITË

e reja për të eksploruar me GP Aviation

VENERA RADA,
gruaja që rigjen veten në Prizren

Stankaj MAGJIA E BJESHKËVE TË RUGOVËS

MONTEL
GROUP

Zgjedhja juaj
ideale për ndriçim
dhe materiale elektrike

Tophane - Prishtine

048 113 800

www.montel-ks.com



MedikaDent
DENTAL CLINIC

+383 43 551 600

Dragodan, Prishtinë



**REPORTING
HOUSE**

ISH-SHTETIA E MALLRAVE
GJERMA, TE SKENDERBEU
E MARTE - E SHITUNE
10:00 - 18:00



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

**Transform your
confidence with
our expert care!**

We specialize in advanced dentistry and precision hair transplant solutions, combining cutting-edge technology with personalized treatments. From radiant smiles to revitalized hair, we're here to help you look and feel as best as possible.

Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP




@dentfix_ks

+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC

CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC

18 VJET PAVARËSI: RRITEMI, FORCOHEMI DHE NJIHEMI

Të dashur lexues,

Muaji i festës së Pavarësisë na gjen sërish bashkë, për të reflektuar mbi rrugëtimin e vendit tonë dhe për të shënuar me krenari 18-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. Ky përvjetor nuk është vetëm një datë në kalendar, por një dëshmi e përpjekjeve, sakrificës dhe vizionit, për një shtet që ndërtohet çdo ditë.

Gjatë këtij viti, vendi ynë ka shënuar një arritje të rëndësishme në arenën ndërkombëtare, duke marrë katër njohje të reja, të cilat forcojnë subjektivitetin shtetëror dhe hapin perspektiva të reja për bashkëpunim politik, ekonomik dhe kulturor. Këto njohje janë rezultat i punës së vazhdueshme institucionale dhe angazhimit të qytetarëve tanë, brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë numër të revistës, do të vazhdojmë t'ju sjellim informacione dhe shumë risi për të panjohurat e vendit tonë,

për njerëzit e suksesshëm që po vazhdojnë të punojnë me ngulm për zhvillimin e tij.

Kultura, biznesi dhe diplomacia mbeten shtyllat mbi të cilat po ndërtohet imazhi i vendit tonë. Ngjarjet kulturore, investimet e reja dhe angazhimi i diasporës dëshmojnë se pavarësia nuk është vetëm një akt historik, por një proces i gjallë zhvillimi dhe konsolidimi.

Si gjithmonë, në këtë edicion do të gjeni edhe këshillat e profesionistëve, rrëfime frymëzuese nga sipërmarrësit vendorë, dhe histori që tregojnë se si vendi ynë, në moshën e tij të re shtetërore, po ecën me hapa të sigurt drejt së ardhmes.

Le të jetë ky 18-vjetor një moment reflektimi, bashkimi dhe besimi, në potencialin tonë të përbashkët. Me çdo njohje të re, me çdo sukses të qytetarëve tanë, pavarësia jonë bëhet më e fortë dhe më kuptimplote.

Gëzuar 18-vjetorin e Pavarësisë!



Adresa: Prishtinë, Mati 1. nr.31
Tel: +383 44 326 143
E-mail: service@gp-aviation.net
marketing@gpmagazine.info
Tel: +383 49 49 94 95





RRUGËTIMI HISTORIK I **PAVARËSISË**



Në një proces të gjatë, me shumë viktima dhe shumë mundime, përfaqësuesit politikë të vendit arritën të bindin aktorët ndërkombëtarë që të mbështesnin Pavarësinë e Kosovës.



Pas një procesi të dialogut, ku u përcaktuan kufijtë dhe forma e qeverisjes së shtetit të ri të pavarur, institucionet e Kosovës në atë kohë hynë në procesin e shpalljes së pavarësisë së vendit.

Procesi i gjatë kishte disa filtra dhe kushtëzime, të cilat duhej të përmbusheshin për të arritur pavarësinë e plotë. Sipas propozimit të Ahtisarit, pavarësia do të ishte e mbikëqyrur nga mekanizma ndërkombëtarë, të cilët vetëm kur do të konfirmonin se standardet ishin arritur, do të largoheshin nga vendi.

2 shkurt 2007: Martti Ahtisaari dorëzon propozimin e tij në



Beograd dhe në Prishtinë. Pas kësaj ngjarjeje, më 26 mars 2007, Martti Ahtisaari ia dërgon raportin përfundimtar Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe ai thotë se Kosova duhet të bëhet e pavarur.

Mbi planin e tij, Kosova do të kishte një pavarësi të mbikëqyrur, me të drejta për pakicat, dhe një sistem qeverisës të decentralizuar.

29 mars 2007: Parlamenti Evropian miraton një rezolutë, në të cilën shprehet përkrahja për pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën me 490 vota pro, 80 kundër dhe 87 abstenime. Bashkimi Evropian në procesin e pavarësisë së vendit do të merrte një rol të rëndësishëm. Misioni i BE-së për sundim të ligjit do të instalohej në vend me një prezencë të policisë, prokurorëve dhe gjykatësve.

5 prill 2007: Kuvendi i Kosovës miraton një deklaratë për përcaktimin e statusit të Kosovës, me të cilën mbështetet propozimi i kryenegociatorit Martti Ahtisaari. Kjo rezolutë i dha drejtim të qartë orientimit për shpalljen e pavarësisë së vendit.

11 qershor 2007: Presidenti amerikan, George W. Bush, deklaroi: “Është koha që të ecet me Planin e Ahtisaarit. Amerika beson që Kosova duhet të jetë e pavarur”. Kjo deklaratë, e dhënë në vizitën në Shqipëri, ishte një mesazh i qartë se Pavarësia e Kosovës ishte e pakthyeshme dhe do të ndodhte sipas Planit të Ahtisaarit.

17 shkurt 2008: Deklarata e Pavarësisë

Deputetët e Kuvendit të Kosovës miratuan Deklaratën e Pavarësisë. Teksti i deklaratës u lexua nga kryeministri Hashim Thaçi. Pas nënshkrimit formal të deklaratës, deputetët miratuan himnin dhe flamurin shtetëror. Në ditët e para vendi u njoh nga fuqitë kryesore ndërkombëtare.

15 qershor 2008: Hyn në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Kosovës, e miratuar solemnisht nga deputetët e Kuvendit, hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Si akti më i lartë i vendit, ajo është një kushtetutë demokratike që mishëron në vete vlerat më të larta evropiane.



AFP

22 korrik 2010: Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vendosi se deklarata e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, nuk ishte shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

Vendimi u lexua nga presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në atë kohë, Hiasashio Ovada.

15 qershor 2014: Misioni për sundim të ligjit i BE-së, EULEX, përfundon mandatin e plotë ekzekutiv. Misioni kishte në përbërje policë, prokurorë, gjykatës e gardianë, të cilët kishin kompetenca ekzekutive. Pas vitit 2014, misioni pati kompetenca të kufizuara, deri në vitin 2018. Nga viti 2018 e tutje, misioni ka rol monitorues.

17 dhjetor 2018: Krijohen Forcat e Armatosura të Kosovës

Me një ligj të veçantë, Kuvendi i Kosovës vendos të formojë forcat e

armatosura të vendit. Deri në këtë kohë, FSK-ja ishte një organizatë e emergjencave civile.

BANKA BOTËRORE (WORLD BANK)

ANËTARE QË NGA VITI 2009;

FOND MONETAR NDËRKOMBËTAR (IMF)

ANËTARE QË NGA VITI 2009-2012;

KOMITETI OLIMPIK NDËRKOMBËTAR (IOC)

ANËTARE QË NGA 9 DHJETORI I VITIT 2014;

FEDERATA NDËRKOMBËTARE E FUTBOLLIT (FIFA)

ANËTARE QË NGA 3 MAJI I VITIT 2016;

KONFEDERATA EVROPIANE E FUTBOLLIT (UEFA)

ANËTARE QË NGA 3 MAJI I VITIT 2016.



REKOMANDIMI YNË: VIZITOJENI LINË NË POGRADEC

Nëse kërkon një destinacion që kombinon bukurinë natyrore, historinë dhe qetësinë e një fshati tradicional shqiptar, Linë në Pogradec është vendi ideal për të eksploruar. Vetëm rreth 12 kilometra larg qytetit të Pogradecit, ky fshat buzë Liqenit të Ohrit ofron një përvojë që do të mbetet gjatë në kujtesë.

Një fshat me histori të lashtë

Linë është i njohur për rrënjët e tij të thella historike. Aty ndodhen mbetje të qytetërimeve ilire dhe romake, përfshirë mozaikë të ruajtur mirë dhe mbetjet e një qyteti antik. Duke shëtitur në rrugicat e fshatit, vizitori ndjen si historia dhe kultura ndërthuren në çdo cep, duke ofruar një ndjesi të veçantë lidhjeje me të kaluarën.

Bukuri natyrore dhe qetësi

Fshati është i vendosur mes maleve dhe liqenit, duke ofruar pamje të mrekullueshme panoramike. Plazhet e liqenit janë ideale për një ditë relaksimi, peshkim ose not, ndërsa rrugicat e qeta dhe shtëpitë tradicionale e bëjnë Linë një vend të përshtatshëm për ecje dhe fotografi. Për ata që duan të largohen nga turizmi i madh, Linë ofron një ambient të qetë dhe autentik shqiptar.

Shija e Linit

Një nga kënaqësitë më të mëdha të vizitës në Linë është ushqimi lokal, veçanërisht peshku i freskët të përgatitur sipas traditës së Liqenit të Ohrit. Restorantet e vogla buzë liqenit ofrojnë specialitete të thjeshta, por të



shijshme, duke kombinuar shijen e natyrës me kulturën lokale.

Aktivitete për çdo vizitor


Përveç shëtitjeve dhe relaksimit, vizitorët mund të përfshihen në aktivitete të ndryshme: ecje nëpër shtigje natyrore, peshkim, fotografim të peizazheve, ose eksplorim të stilit arkeologjik të Linit, një thesar i fshehur për adhuruesit e historisë.

Si të arrini atje

Linë është i lehtë për t'u arritur nga Pogradeci – mund të përdorni makinë, taksi ose edhe biçikletë për një aventurë më të gjallë. Rruga është e mirë dhe gjatë gjithë udhëtimit mund të shijoni pamje mahnitëse të liqenit dhe maleve përreth.

CURRENTLY OPERATING
IN  26 LOCATIONS
AND 3 COUNTRIES

SINCE 2009 - ONLY THE BEST INGREDIENTS



SACHPIZZA®

www.sachpizza.com

nga turme e drurit

1

FIRST AND
THE LARGEST

WOOD FIRED PIZZA
CHAIN IN THE REGION

SACHPIZZA




**SACH
PIZZA**


KUSH JEMI NE?

Dardania Model është një fabrikë që prodhon dyer dhe dritare nga materiale si PVC, alumin, dru-alumin, si dhe mobilie përmes një departamenti të veçantë. Kompania vepron që nga viti 1958 dhe produktet e saj përmbushin standardet ndërkombëtare për efikasitet termik, performancë, dizajn, cilësi, dhe qëndrueshmëri.



Dyer

Dyert tona prej druri kombinojnë elegancën, sigurinë dhe qëndrueshmërinë, të personalizueshme sipas stilit dhe nevojave tuaja. Në Dardania Model, krijojmë dyer që përmirësojnë çdo hapësirë të shtëpisë tuaj.



Dritare

Dritare prej druri, alumini, PVC, me materiale cilësore sjellin stil, qëndrueshmëri dhe efikasitet energjie, të personalizueshme sipas nevojave tuaja. Në Dardania Model, përmirësojmë çdo hapësirë me dizajn dhe funksionalitet.

Legjenda E SUKSESEVE TË SPORTIT

Kosovarët do ta mbajnë mend çdo lajm të mirë për sportin, duke e kujtuar lajmëtarin e çdo zhvillimi pozitiv. Fadil Vokrri, futbollist që në kohën e Jugosllavisë u shndërrua në krenarinë e futbollit kosovar, ishte personi më meritues për anëtarësimin e Kosovës në FIFA dhe UEFA. Në selitë e këtyre organizatave dhe partnerëve Vokrri arriti të llobojë dhe t'i bindë federatat që të pranojnë Kosovën

në familjen e futbollit botëror.

Ai do të kujtohet nga gjeneratat e sporti si lajmëtar i çdo lajmi pozitiv për anëtarësimin në UEFA dhe FIFA, një arritje historike, që shënoi hapjen e dyerve të futbollit kosovar në skenën ndërkombëtare.

Fadil Vokrri, legjendë e futbollit kosovar, vdiq në vitin 2018, duke lënë prapa vetes një karrierë të gjatë e të suksesshme. I lindur në vitin 1960, në fshatin Sfeçël të Podujevës, Vokrri mbetet një ikonë e futbollit në Kosovë, i



adhuruar nga gjenerata të tëra sportdashësish.

Në vitet e 80-ta, Fadil Vokrri arriti kulmin e karrierës së tij si futbollist. Ai e filloi karrierën me KF Llapin e Podujevës dhe më pas kaloi te KF Prishtina, ndërsa luajti edhe për KF Partizanin e Beogradit. Në vitin 1987, klubi italian Juventus shprehu interesim për të nënshkruar një kontratë disavjeçare me të. Në të njëjtin vit, Vokrri u vlerësua si futbollisti më i mirë i vitit në Jugosllavi.

Trajneri Miroslav Blazheviq e konsideronte Vokrrin sulmuesin më të mirë të qendrës në Jugosllavi, por shërbimi i detyruar ushtarak e detyroi të luante për KF Partizanin e Beogradit. Vokrrit, gjithashtu, iu ofrua mundësia të luante për Dinamon e Zagrebit, por ai zgjodhi





Partizani për arsye afërsie dhe simpatizuesish në Kosovë.

Gjatë karrierës së tij, Fadil Vokrri luajti 12 ndeshje për ekipin përfaqësues të Jugosllavisë, duke shënuar 5 gola. Ai luajti edhe për NIM në Francë dhe më vonë për Fenerbahçen e Turqisë (1990-1992), duke korrur shumë suksese. Pas përfundimit të karrierës si futbollist, u vendos në Francë dhe u bë trajner i një ekipi të ligës së dytë. Më pas u kthye në Kosovë dhe jetoi në Prishtinë.

Në shkurt të vitit 2008, Fadil Vokrri u zgjodh president i Federatës së Futbollit të Kosovës me mandat katërvjeçar. Nën udhëheqjen e tij, Kosova u pranua në Federatën Ndërkombëtare të Futbollit

(FIFA), më 3 maj 2016, dhe në Konfederatën Evropiane të Futbollit (UEFA) po në të njëjtën datë – një arritje historike që e bëri Kosovën pjesë të familjes së madhe të futbollit botëror dhe evropian.

Fadil Vokrri do të mbahet

mend jo vetëm si futbollist i jashtëzakonshëm, por edhe si arkitekt i hapjes së dyerve të futbollit kosovar drejt botës, duke lënë një trashëgimi të paharrueshme për sportin në vend.



TRANSPORT

PËR MALLËRA DHE AUTOMOBILË

KOSOVË  ZVICËR  KOSOVË



SHËRBIMET:

- ☒ Përvojë shumëvjeçare
- ☒ Siguri maksimale
- ☒ Infrastrukturë moderne
- ☒ Profesionalizëm
- ☒ Kapacitete të mëdha
- ☒ Çmime konkurruese

ZVICËR:
+41 76 700 2121 | +41 79 640 1306

KOSOVË:
+383 48 33 69 88





BERG AM LAIM
BAUMKIRCHNER STR.12
TEL:+491623962484



BACKEREI OREX KONDITOREI

SHIJE E VËRTETË SHQIPTARE!

Mirësevini në furrat tona në München, aty ku tradita dhe shija bashkohen në çdo produkt! Nga buka e sapopjekur me brumë të punuar me dorë, deri te byrekët krokantë e embëlsirat tradicionale, ne sjellim aromën dhe shijen e kuzhinës shqiptare në tryezën tuaj. Ejani të shijoni recetat e trashëguara brez pas brezi, të përgatitura me përhërës natyralë dhe dashuri!



POSTENRIEDER-ALLE
WINTETTHURER STR.2
TEL: +4915510382613



BACKEREI OREX KONDITOREI
Traditionelles Handwerk

**TRADITË,
SHIJE
DHE CILËSI**

PROJEKTET TONA AKTUALE:



PARK RESIDENCE, PRISHTINË

Në zemër të Prishtinës

📍 Rr. Holger Petersen

☎ +383 44 458 458

PARK TOWERS, PODUJEVË

Komoditet, cilësi në Podujevë

📍 Rr. Zahir Pajaziti

☎ +383 48 458 456



OBILIQ

E ardhmja e jetesës moderne

📍 Afër shkollës "Ibrahim Rugova" ☎ +383 49 967 700

FUSHË KOSOVË

Jeta e re, ndërtuar me kujdes

📍 Rruga e Uapit

☎ +383 44 458 458



VITI

Zgjedhja më e mirë për të investuar

📍 Kongresi i Manastirit

☎ +383 46 458 458

MERRNI HAPIN E DUHUR PËR TË SIGURUAR

të ardhmen tuaj...



RRETH NESH:

Në Berisha Group, besojmë se suksesi ynë është rezultat i një bashkëpunimi të fortë dhe të pandashëm mes secilit anëtar të ekipit tonë. Secili anëtar i kontribuon rritjes dhe zhvillimit të kompanisë me ekspertizën dhe profesionalizmin që ata ofrojnë në sferat që punojnë. Në secilin projekt që ndërmarrim, angazhohemi për të punuar së bashku për të siguruar që cilësia, profesionalizmi dhe integriteti të jenë në qendër të çdo faze të punës. Për ne, bashkëpunimi dhe komunikimi i hapur janë pika kyçe për të arritur rezultatet më të mira, dhe çdo sfidë është mundësi për t'u rritur dhe për të mësuar së bashku.

MISIONI YNË:

Misioni ynë është të krijojmë projekte të pasurive të patundshme që ofrojnë cilësi të jashtëzakonshme, qëndrueshmëri dhe mundësi investimi afatgjata, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e qytetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Ne jemi të përkushtuar për të zhvilluar hapësira moderne dhe komode që përbushin jo vetëm nevojat e klientëve tanë, por edhe synimet e tyre për një jetë më të mirë dhe më të sigurt.

Çdo projekt i Berisha Group është një hap drejt ndërtimit të një të ardhmeje më të qëndrueshme, duke u fokusuar në përdorimin e materialeve të cilësisë më të lartë dhe duke integruar teknologjitë më të avancuara për të siguruar efikasitetin energjetik dhe cilësinë e jetesës.

DIVIZIONET TONA:





STANKAJ – MAGJIA E BJESHKËVE TË RUGOVËS

Ruga që të çon drejt Stankajt duket sikur të largon gradualisht nga gjithçka e zakonshme. Sa më thellë futesh në Rugovë, aq më shumë heshtja e bjeshkëve fillon të flasë. I rrethuar nga male madhështore dhe pyje të dendura, Stankaj shfaqet si një fshat i vogël, por me një shpirt të madh, ku koha duket se ecën më ngadalë.

Në këtë fshat, natyra dhe njeriu jetojnë në harmoni. Vila të rehatshme, të ndërtuara me kujdes për të mos prishur peizazhin, presin vizitorët që kërkojnë qetësi dhe ngrohtësi. Disa restorante tradicionale, me oxhaqe të ndezura dhe tavolina druri, ofrojnë një ndalesë të ngrohtë për këdo që vjen për herë të parë. Aty, mikpritja rugovase ndihet që në hapin e parë.

Dimri i jep Stankajt një magji të veçantë. Bora mbulon çdo cep të fshatit, çatitë, shtigjet dhe livadhet, duke e shndërruar atë në një kartolinë të gjallë. Zhurma e vetme është kërcitja e borës nën këmbë dhe era e

lehtë që zbret nga bjeshkët. Në këtë qetësi, njeriu gjen kohë të ndalet, të marrë frymë thellë dhe të shijojë bukurinë e pastër që ofron natyra.

Por Stankaj tregohet më së miri rreth sofrës. Ushqimet tradicionale të Rugovës janë një rrëfim më vete. Mishi i përgatitur sipas zakoneve vendore, djathi i Rugovës me shije të fortë e të veçantë, produktet e qumështit, si qumështi, kosi dhe gjalpi, dhe ushqimet tradicionale shqiptare, sjellin në tryezë historinë dhe traditën e kësaj treve. Çdo kafshatë flet për punën, durimin dhe lidhjen e fortë të banorëve me tokën dhe bjeshkët.

Stankaj nuk është thjesht një fshat për t'u vizituar. Është një rrëfim që përjetohet ngadalë, mes natyrës së hatashme, mikpritjes së sinqertë dhe shijeve tradicionale. Një vend ku largohesh për pak ditë, por që të mbetet gjatë në kujtesë.





A JE
GJALLË?



The beauty
remains eternal

www.kerasan.net
  [kerasankosova](https://www.instagram.com/kerasankosova)

REPORTING HOUSE

PËRKRAHENI MUZEUN "REPORTING HOUSE" ME DONACIONIN TUAJ



Xhirollogaria e BIRN për Donacione të Muzeut Reporting House

EMRI I PËRFITUESIT: RRJETI BALLKANIK I GAZETARISË HULUMTUESE
 ADRESA E PËRFITUESIT: MENSA E STUDENTËVE, KATI I PARË
 PRISHTINA 10000, REPUBLIKA E KOSOVËS
 BANKA E PËRFITUESIT: TEB J.S.C.
 ADRESA E BANKËS SË PËRFITUESIT: MBRETËRESHA TEUTA, PRISHTINA,
 REPUBLIC OF KOSOVA

BIRN's Bank Account for Donations to the Reporting House Museum

BENEFICIARY NAME: RRJETI BALLKANIK I GAZETARISË HULUMTUESE
 BENEFICIARY ADDRESS: MENSA E STUDENTËVE, KATI I PARË, PRISHTINA,
 10000, REPUBLIC OF KOSOVA
 BENEFICIARY BANK: TEB J.S.C.
 BENEFICIARY BANK ADDRESS: MBRETËRESHA TEUTA, PRISHTINA,
 REPUBLIC OF KOSOVA

VIZITONI MUZEUN "REPORTING HOUSE"

LOKACIONI: ISH-SHTËPIA E MALLRAVE GËRMIA, TE SKËNDERBEU
 E MARTË - E SHTUNË | 10:00 - 18:00*

LLUGARIA BANKARE / IBAN: **XK05 2032 0002 5556 3435**
 ACCOUNT NUMBER / IBAN:
 SWIFT CODE: TEBKXKPR

RRUGA PËRTEJ FORMËS



Nje qasje moderne dhe elegante në dizajnin e brendshëm. Dyert Filomuro të njohura për integrimin e tyre të plotë me murin, ato eliminojnë kornizat tradicionale dhe krijojnë një vazhdimësi vizuale që e bën ambientin të duket më i gjerë, më harmonik dhe më bashkëkohor.



Kuzhinat moderne bashkojnë linja të pastra dhe funksionalitet të zgjuar për një hapësirë elegante e praktike. Me materiale cilësore dhe dizajn minimalist, ato sjellin harmoni dhe efikasitet në çdo ditë.





TRI MËNYRA PËR TË MUNDUR DEPRESIONIN E DIMRIT

Stina e ftohtë nuk është e dashur për të gjithë njerëzit dhe në situatat më të këqija disa mund të kenë edhe çrregullime depresioni për shkak të dimrit. Çrregullimi Afektiv Sezonal (SAD), ose “depresioni i dimrit”, mund të prekë këdo. Për ata që e kanë të vështirë të vazhdojnë aktivitetet e tyre të përditshme normale, NHS këshillon të kontaktojnë mjekun e familjes (GP). Për ata me simptoma më të lehta, janë tri mënyra për t’ju ndihmuar të përballoni ditët më të errëta dhe madje t’i përqafojnë ato.

1. Përqendrohuni tek ajo që mund të bëni

Psikologja Kari Leibowitz thotë se, duke u rritur në ShBA, në një qytet të përqendruar te vera, ajo e shihte dimrin si kufizues dhe të pakëndshëm. Por udhëtimi në Norvegji, pasi në disa vende nuk ka pothuajse fare dritë ditore në kulmin e dimrit, ia ndryshoi mënyrën e të menduarit.

Ajo vuri re se, në vend që njerëzit të dorëzoheshin përballë humorit të zymtë, ata i përqafojnë rrethanat, duke gjetur hobi të ndryshëm – nga sportet e dimrit të thurja dhe gatimi. “Ata e shohin dimrin si një periudhë të vitit plot mundësi”, thotë ajo.

Leibowitz thotë se kjo i mësoi se ndryshimi i qasjes, duke u përqendruar te ajo që mund të bësh gjatë kësaj kohe, në vend të asaj që nuk mundesh, ishte çuditërisht efektiv. Kjo mund të përfshijë shëtitje dimërore, mbrëmje

filmash, gatimin e një ushqimi të ri, ose patinazh mbi akull. “Shpesh përqendrohemi vetëm te gjërat që janë më të vështira për t’u bërë në dimër, kur në të vërtetë ekziston një botë e tërë aktivitetesh sezonale që ndihen më mirë kur jashtë është ftohtë.”

2. Pranoni që keni nevojë për më shumë pushim

Me kalendaret tanë të punës dhe jetës shoqërore, që vazhdojnë si zakonisht, mund të pyesim veten pse ndihemi kaq të lodhur. Por, Kari Leibowitz thotë se duhet ta pranojmë se trupat tanë kanë nevojë për më shumë pushim në dimër.

“Në fakt, është mirë të mos jeni aq produktivë apo aktivë sa në muajt e verës, sepse trupat tanë janë biologjikisht të programuar për pushim gjatë dimrit”, thotë ajo.

Ashtu si kafshët dhe bimët, ajo thotë se duhet të ngadalësojmë ritmin dhe të ndryshojmë sjelljen tonë.

Dr. Em May Armstrong, studiuese e bimëve, thotë se çelësi është gjetja e ekuilibrit mes pushimit më të madh dhe shmangies së plogështisë së tepërt. Ajo sugjeron të ashtuquajturin “gjumë aktiv” - kombinimin e një stili jete më të ngadaltë dhe pushues me aktivitete që na mbajnë ende të angazhuar mendërisht.

Këto mund të përfshijnë aktivitete si thurja, riparimi i rrobave, ose praktika që ju ndihmojnë të

përgatiteni për vitin që vjen.

“Dhe, edhe pse kjo nuk është aq aktive sa, për shembull, udhëtimi ose kampingu, është po aq aktive në një mënyrë më rikuperuese”.

3. Bëni plane

Ndërsa pushimi më i madh është i natyrshëm, është ende e rëndësishme të gjeni kohë për gjërat që ju bëjnë të lumtur dhe të shoqëroheni me njerëz të tjerë, sipas mjekut të familjes, Gavin Francis. “Ne jemi qenie shumë shoqërore. Edhe njeriu më i vetmuar nuk jeton plotësisht i vetëm. Të gjithë varem nga të tjerët.” Ai sugjeron planifikimin e aktiviteteve paraprakisht, duke u përqendruar te kalimi i kohës me ata që ju bëjnë të ndiheni mirë dhe tek aktivitetet që mund të përmirësojnë humorin tuaj. Kjo do të thotë që ju jeni të angazhuar dhe një humor i ulët më afër kohës nuk do të mund t’ju ndalojë. “Pastaj mund të filloni të planifikoni në agjendën tuaj më shumë gjëra për të bërë me këta njerëz gjatë dimrit”, thotë ai. Gjithashtu, janë të rëndësishme gjëra të thjeshta dhe praktike për të përmirësuar humorin, si sigurimi i një gjumi të mirë gjatë natës, shmangia e alkoolit të tepërt ose festave të vona dhe mbajtja e një diete të shëndetshme.

“Këto gjëra nuk janë shkencë raketash, por janë vërtet themelore për të pasur një ritëm cirkadian të mirë dhe një fiziologji të shëndetshme gjatë dimrit”.



Temaj Qeramikë



temaj.qeramike



www.temaj.eu



temaj.qeramike




temaj
QERAMIKE

ZGJEDH, KOMBINO E STILIN TËND KRIJO

ATY KU KUALITETI NDRIQON SHTEPINË TUAJ!



TEMAJWinDoor



Temaj Window



temaj.window



www.temaj.eu



temajwindow



AROMA QË TA KUJTON PRIZRENIN

Gentiana Ahmeti

Ka qytete që të mbetin në mendje për pamjen, të tjera për historinë. Prizreni, ndërkaq, të mbetet në kujtesë për aromën. Një aromë që të udhëheq rrugicave me kalldrëm, të ndalë pranë Shadërvanit dhe të bind se ky udhëtim nuk mund të përfundojë pa një pjatë qebabash të ngrohtë. Kush e viziton Prizrenin, rrallë kthehet në shtëpi pa i provuar, sepse këtu qebapi nuk është thjesht ushqim, por rit.

Në zemër të qytetit, jo larg Shadërvanit, qebaporet janë pika takimi për vendasit, turistët dhe mërgimtarët. Janë vende ku koha duket se ecën më ngadalë, ndërsa shija mbetet e njëjtë prej dekadash. Dy prej këtyre historive të shijes dhe traditës janë qebaportja “Skeja” dhe qebaportja “Hilmi”, biznese familjare që e mbajnë gjallë një zanat të trashëguar brez pas brezi.

Zanati që trashëgohet me zemër

Jasin Skeja, 23 vjeç, është fytyra e re e një biznesi me rrënjë të thella. Qebaportja e familjes së tij numëron 23 vjet, ndërsa Jasin ka pesë vjet që punon aty me përkushtim.

“Këtë punë e bëj me shumë qejf. Kam pasur dëshirë që këtë zanat me trashëgu nga babi”, thotë ai me krenarinë e dikujt që e sheh veten

pjesë të një vazhdimësie.

Në menynë e Skejas nuk ka dilema: qebapë ose, siç i quajnë vendasit, qofte, janë ylli kryesor. Me një çmim rreth 60 centë për copë, thjeshtësia shndërrohet në avantazh. “Ne ofrojmë vetëm qofte, kemi edhe pesakavica, por më së shumti preferohen këto”, shpjegon Jasin. Sezonet më të ngarkuara? Vera dhe dimri, kur Prizreni mbushet me diasporë dhe turistë nga Turqia e Gjermania. Shpresa e tij është e qartë: puna të vazhdojë mirë dhe rrjeti të zgjerohet me pika të reja, pa e humbur kurrë shijen autentike.

Tri dekada përkushtim dhe shije

Pak hapa më tutje, historia e Hilmi Paçarizit flet për përkushtim të hershëm dhe këmbëngulje. Ai e bën këtë punë prej 31 vjetësh dhe prej 21 vjetësh e mban biznesin e tij me emrin “Hilmi”. Rrugëtimi i tij ka nisur

herët në moshën 11-vjeçare, në një kohë tjetër për shkollën dhe zanatin.

“Fillimisht kam punu në qebaptoresh ‘Sarajeva’, e hapur që nga viti 1965, e cila tash është mbyllur”, kujton ai, duke na kthyer në një kapitull të rëndësishëm të historisë së qytetit.

Sot, Hilmiu punon me gruan dhe djalin, bashkë me një punëtor, një tjetër biznes familjar dhe puna ndahet dhe shija ruhet. Menyja është po aq e drejtpërdrejtë: qebapë dhe vishla, me çmime që sillen rreth 60 centë. Thjeshtësi, cilësi dhe besnikëri ndaj shijes që e ka bërë Prizrenin të famshëm.

Qebapët e Prizrenit nuk kanë nevojë për prezantim të gjatë. Ata flasin vetë, me aromë, me shije dhe me historitë e njerëzve që i përgatisin çdo ditë. Për vizitorët, janë një ndalesë e domosdoshme; për vendasit, pjesë e përditshmërisë; për mërgimtarët, shije e mallëngjimit.



SHIJE E PAREZISTUESHME



 vipaofficial
 vipa.official
 Vipa Chips

vipa

<https://www.vipa-ks.com>



ÇKA EKSPORTON KOSOVA?

Kosova ka realizuar gjithsej 898 milionë euro eksporte gjatë vitit 2025, duke shënuar një nivel të konsiderueshëm të aktivitetit të saj në tregtinë e jashtme. Të dhënat e Doganës së Kosovës, të përpunuara nga Instituti GAP, tregojnë një strukturë të qartë rajonale dhe evropiane të eksporteve, e cila ka ruajtur stabilitetin gjatë periudhës 2022–2024.

Shqipëria vazhdon të jetë partneri kryesor i eksportit të Kosovës për vitin 2025, me një vlerë prej 159 milionë euro, duke ruajtur pozitën e parë edhe krahasuar me vitet e mëparshme. Në vendin e dytë renditet Maqedonia e Veriut, me 137 milionë euro, ndërsa Gjermania zë vendin e tretë, me 102 milionë euro eksporte. Kjo tregon se tregjet rajonale mbeten ende bazament i stabilitetit të eksporteve kosovare, ndërsa partnerët evropianë ofrojnë mundësi për rritje dhe zgjerim të vazhdueshëm.

Në dhjetëshen e partnerëve kryesorë të eksporteve për vitin 2025 përfshihen edhe Zvicra (95 milionë euro), Serbia (61 milionë euro), Mali i Zi (56 milionë euro), Turqia (33 milionë euro), Italia (28 milionë euro), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (23 milionë euro) dhe Franca (20 milionë euro). Ky grup partnerësh tregon orientimin e qartë rajonal dhe evropian të eksporteve kosovare,

me një pjesëmarrje të konsiderueshme edhe të tregjeve ndërkontinentale si ShBA-ja.

Analiza krahasuese e periudhës 2022–2024 tregon se struktura e partnerëve tregtarë ka mbetur relativisht stabile. Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Gjermania vazhdojnë të dominojnë eksportet, ndërsa disa tregje si ShBA-ja dhe Franca kanë shënuar lëvizje pozitive në renditje, duke treguar potencial për zgjerim të mëtejshëm.

Sipas Institutit GAP, këto shifra dëshmojnë për nevojën e diversifikimit të tregjeve dhe produkteve eksportuese, si një hap i domosdoshëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe uljen e varësisë nga tregjet tradicionale rajonale. Rritja e eksporteve drejt tregjeve të reja, sidomos atyre ndërkontinentale, mund të rrisë konkurrueshmërinë e produkteve kosovare dhe të mbështesë zhvillimin e sektorëve kryesorë ekonomikë në vend.

Në përfundim, Kosova ka arritur një nivel të qëndrueshëm të eksporteve dhe ka krijuar bazament të fortë për rritje të mëtejshme, por sfida kryesore mbetet zgjerimi i tregjeve dhe diversifikimi i produkteve, për të siguruar një zhvillim ekonomik më të qëndrueshëm dhe të larmishëm.

Vitamina • Minerale • Hekur • Proteina



Sempre

Rritemi së bashku me minerale dhe vitamina.

Biskotat Sempre janë të prodhuara nga përbërës të ushqyeshëm, duke i siguruar fëmijës tuaj vitamina dhe minerale thelbësore.

Duke kafshuar dhe përtypur biskotat Sempre, më të vegjlit tuaj stimulojnë mishin e dhëmbëve dhe lehtësojnë daljen e dhëmbëve të parë.



Një porcion (100g) SEMPRE biskota përmban:

Energji	Proteina	Sheqer	Yndyrna	Natrium
343 kcal 18%	9.0 gram	24.13 gram	10 gram	0.3 gram

Vlera mesatare e rekomanduar për fëmi në bazë ditore për konsumim prej 1800 kcal





SHKURTI DHE MARS SJELLIN GJALLËRI *kulturore në Kosovë*



Muajt shkurt dhe mars në Kosovë karakterizohen nga një kalendar i pasur aktivitetesh kulturore dhe artistike, që bashkojnë muzikën, historinë dhe angazhimin shoqëror.

Muaji shkurt shënon 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë së Kosovës, e cila këtë vit feston 18-vjetorin. Në të gjitha qytetet e vendit organizohen ceremoni solemne, parada ushtarake, performanca muzikore dhe aktivitete artistike, me pjesëmarrje të gjerë qytetare. Si pjesë e festimeve, Filharmonia e Kosovës realizon edhe një koncert të veçantë klasik/orkestral, duke i dhënë kësaj date një dimension solemn dhe artistik.

Në muajin mars, Prishtina bëhet qendër e muzikës klasike me një koncert madhor, pasi Orkestra dhe Kori i Filharmonisë së Kosovës bashkohen me Konzertchor Münster dhe Choralspace Festival Choir, nën dirigjimin e Marion Wood. Në program janë vepra nga Antonín Dvořák, Valton Beqiri dhe Robert Schumann, ndërsa koncerti do të mbahet në Prishtinë, më 20 mars 2026.

Muaji mars sjell gjithashtu 8 Marsin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas, e cila shënohet me aktivitete të shumta kulturore dhe artistike, të organizuara nga organizata joqeveritare dhe qendra kulturore, duke vënë në fokus zërin dhe rolin e grave në shoqëri.

Këta dy muaj dëshmojnë se Kosova ofron një jetë kulturore aktive dhe të larmishme, ku arti dhe kultura mbeten pjesë e rëndësishme e jetës publike.





20

YEARS TOGETHER





ÇAJI I MALIT SHQIPTAR – NJË SHIJE E NATYRËS

Nëse e vizitoni Shqipërinë, çaji i malit (Sideritis) është një përvojë që nuk duhet humbur. Ky çaj tradicional, me aromë tokësore dhe shije të veçantë, është i pasur me antioksidantë dhe ofron përfitime për shëndetin tretës, zemrën dhe imunitetin.

Si përgatitet: Lëreni të ziejë lulet dhe kërcellin e bimës 5-10 minuta dhe shtoni mjaltë, limon ose qumësht sipas dëshirës.

Varieteti shqiptar, Sideritis Raeseri, njihet për

cilësinë e lartë dhe efekte të fuqishme shëndetësore. Një filxhan çaji malor është një udhëtim i vogël në zemër të natyrës shqiptare.

PËRGATITJA:

- Përdorni lulet, kërcellin dhe gjethet e bimës;
- Hidheni në ujë të nxehtë dhe lëreni të ziejë për 5-10 minuta;
- Shtoni mjaltë, limon ose qumësht sipas shijes.



ibas

www.ibas.world

038 600 300

MOS PAGUAJ provizion për me çu pare në Kosovë!

Si funksionon?



- Familjari yt hap një llogari IBAS në Kosovë;
- IBAS i gjeneron një konto numër (IBAN anglez) me qasje në SEPA;
- Ju transferoni nga konto numri juaj nga cilado bankë në Evropë, në konto numrin e familjarit tuaj që e ka hapur në IBAS;
- Paratë mbërrijnë brenda sekondave në Kosovë;
- Ju nuk paguani provizion, sepse transferi juaj llogaritet si brenda Zonës Ekonomike Evropiane;
- Familjari yt paguan me Mastercard të IBAS nëpër dyqane ose i tërheq paratë, PA PROVIZION, në bankomatët e cilësdo bankë në Kosovë.



Llogaria **PREMIUM**

- IBAN të Kosovës dhe IBAN të Anglisë me qasje në **SEPA** (Sistemin e pagesës të Bashkimit Evropian);
- Dy transfere **PA TARIFË**, për çdo muaj nga Bashkimi Evropian;
- Aktivizim me një klik të 750 eurove kredi për pagesa, **PA INTERES** për 3 muaj;
- Kartelë të Mastercard për realizimin e pagesave në POS, **PA TARIFË**;
- Dy tërheqje në muaj, **PA TARIFË** në bankomatët e çfarëdo banke në Kosovë.

Llogaria **REMITENCA**

Kujdesi Shëndetësor

- IBAN të Kosovës dhe IBAN të Anglisë me qasje në **SEPA** (Sistemin e pagesës të Bashkimit Evropian);
- Sigurim shëndetësor spitalor **deri në 25,000 euro**;
- Dy transfere **PA TARIFË**, për çdo muaj nga Bashkimi Evropian.



Skano këtë QR code për ta hapur ueb faqen dhe dërgo tek familjari yt për ta instaluar aplikacionin e IBAS dhe hapur **konto numrin online**.

Hapja e llogarisë në IBAS është pa pagesë.

SISTEMI BANKAR I KOSOVËS, RITJE KURSIMESH DHE INVESTIMESH

Intervistoi: Gentiana Ahmeti

Banka Qendrore është rregullatori kryesor i sistemit financiar në një vend. Në një intervistë për GP Magazinë, drejtori i BQK-së, Ahmet Ismaili, tregon sfidat dhe zhvillimet e sektorit financiar në vend.

GP Magazinë: Cilët janë treguesit kryesorë që dëshmojnë për forcimin e sistemit financiar të Kosovës në vitet e fundit?

Ahmet Ismaili: Sistemi financiar i Kosovës ka shënuar një avancim të dukshëm gjatë viteve të fundit dhe kjo reflektohet qartë te treguesit kryesorë të performancës, raporteve ndërkombëtare, siç janë ato të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, Komisionit Evropian, ndërsa validohen edhe nga vlerësimi sovran kreditor i vendit nga Fitch Ratings.

Së pari, kapitalizimi i bankave ka mbetur i qëndrueshëm dhe mbi nivelet minimale ligjore, derisa asetet e sektorit financiar janë rritur mbi baza dyshifrore çdo vit, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është rritur dhe ka arritur në 17.2% në shtator 2025, duke siguruar një nivel adekuat ndaj rreziqeve të papritura.

Së dyti, likuiditeti i bankave është i menaxhuar mirë. Treguesi i Mbulimit me Likuiditet (LCR) ka qenë mbi 200% gjatë dy viteve të fundit, duke arritur 235.6% në shtator 2025 dhe Treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) mbetet mbi 130%, gjë që tregon aftësi të forta për përballimin e kërkesave të depozituesve dhe situatave të paparashikuara. Kjo është e rëndësishme veçanërisht duke pasur parasysh se depozitat janë baza kryesore e kreditimit nga bankat, ndërsa kreditimi është rritur vazhdimisht me ritme më të shpejta se depozitat.

Një tregues tjetër i rëndësishëm



është cilësia e portofolit të kredive. Kreditë joperformuese kanë mbetur në nivele të ulëta, rreth 2.1% në shtator 2025, duke reflektuar menaxhim të kujdesshëm të rrezikut nga bankat dhe disiplinë financiare të mirë në ekonomi. Para së gjithash, një nivel i tillë i lartë i kredive performuese (pra rreth 98%), është rezultat edhe i disiplinës financiare të kredimarrësve, e cila vlerësohet lart dhe ka mundësuar që kreditimi të rritet vazhdimisht dhe në shifra dyshifrore, duke bërë që raporti ndërmjet depozitave dhe kredive të arrijë gati 90%, si dhe norma e ndërmjetësimit financiar (raporti midis Kredive dhe Bruto Produktit Vendor/BPV) të jetë në nivelin e vendeve të rajonit.

Një tregues kyç i besimit të publikut në sistemin financiar shihet nga rritja e vazhdueshme e depozitave dhe kredive që nga pandemia COVID-19. Depozitat e qytetarëve dhe bizneseve kanë arritur në 7.34 miliardë euro në shtator 2025, që përkthehet në një rritje mesatare vjetore prej rreth 10.5%, ndërsa kreditë në 6.45 miliardë euro, me një rritje mesatare vjetore prej rreth 13.1%. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim në kreditim ka luajtur edhe Fondi për Garanci Kreditorë,

i cili përmes dritareve të synuara, ka kontribuar në rritjen e kreditimit në sektor specifik, me efekte të shumanshme pozitive në gjithë ciklin e ekonomisë.

Ky nivel i qëndrueshëm i rritjes tregon përdorim efektiv të depozitave për kreditim, duke ruajtur një raport kredi/depozita të shëndetshëm prej 87.8% në shtator 2025 dhe njëkohësisht ruan likuiditetin dhe stabilitetin e sektorit bankar.

Përveç treguesve financiarë, kemi bërë përpjekje të dukshme edhe në kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse. Forcimi i strukturave të brendshme të BQK-së, zhvillimi i kapaciteteve për mbikëqyrje efektive dhe përputhja me standardet ndërkombëtare rrisin transparencën dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Kjo është bërë me mbështetje të fortë të partnerëve ndërkombëtarë, kryesisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, bankat qendrore partnere, si dhe institucionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.

Në përmbljedhje, treguesit kryesorë, sikurse janë kapitali i lartë, likuiditeti i fortë, portofoli kreditor me cilësi të lartë dhe rritja e besimit të publikut,

të reflektuara në të gjitha raportet ndërkombëtare të lartpërmendura, dëshmojnë se sistemi financiar i Kosovës është forcuar dukshëm dhe është i gatshëm të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit edhe në vitet e ardhshme.

GP Magazinë: Banka Qendrore është një nga institucionet më të rëndësishme për ruajtjen e stabilitetit të euros në vend. Si arrini ta balanconi këtë pa pasur monedhë kombëtare?

Ahmet Ismaili: Në Kosovë, euroja është valuta jonë dhe si instrument ligjor i pagesës, përkundër që paraqet një sërë përfitimesh strategjike të padiskutueshme, njëkohësisht është evidente mungesa e një monedhe kombëtare që e bën rolin e BQK-së edhe më sfidues në aspekt të politikës klasike monetare. Megjithatë, përfitimet e përdorimit të saj në Kosovë kanë qenë të shumanshme dhe veçanërisht janë të rëndësishme në rrugën tonë drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Prandaj, në këto kushte, detyra jonë është të ruajmë integritetin e euros, të sigurojmë stabilitetin e sistemit financiar dhe të mbështesim zhvillimin ekonomik të vendit.

Ne bashkëpunojmë ngushtë me Bankën Qendrore Evropiane për të parandaluar falsifikimin e eurove dhe për të përfurcuar sigurinë e sistemit monetar. Ky bashkëpunim na integron në rrjetin profesional të Eurosystem-it dhe partnerëve rajonalë, duke rritur kapacitetin tonë operativ dhe përkushtimin institucional. Së fundi, kemi nënshkruar për herën e parë një marrëveshje me Bankën Qendrore Evropiane, përkatësisht me presidenten Lagarde, pikërisht në kuptim të avancimit të kapaciteteve dhe shkëmbimit të informacioneve në ruajtjen e integritetit të euros. Përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane, BQK-ja tani merr pjesë në rrjetet e Eurosystem-it dhe ka qasje në mekanizmat operativë për parandalimin dhe luftimin e falsifikimit të euros. Kjo e rrit besueshmërinë dhe stabilitetin e të gjithë sistemit tonë financiar.

Këto përpjekje vijnë ato që ndërmorëm kohë më parë, duke siguruar sovranitetin dhe integritetin monetar, që, përveç rëndësisë në

nivel të sistemit monetar dhe financiar të vendit, ligjshmërisë në ushtrimin e aktivitetit financiar vetëm nga institucionet e licencuara nga BQK-ja, ka kontribuar në rritjen e sigurisë së transaksioneve të qytetarëve si në aspektin e sigurisë ligjore, ashtu edhe në aspektin e mbrojtës së konsumatorit.

Krahas kësaj, në kuadër të aspekteve të avancimit të furnizimit të ekonomisë me para, në aspektin e avancimit të kryerjes së pagesave, kemi nisur projekte konkrete për modernizimin e infrastrukturës së pagesave dhe transformimit digjital, që janë prioritet strategjik. Përgatitjet për aplikim dhe anëtarësim në Zonën e Vetme të pagesave të BE-së, e njohur si SEPA, si dhe projektet e infrastrukturës së pagesave si projekti TIPS Clone me Bankën e Italisë, Open Banking, QR Code dhe Request-to-Pay po ndryshojnë mënyrën se si qytetarët dhe bizneset realizojnë transaksionet, duke e bërë sistemin më të shpejtë, më të sigurt dhe të integruar me standardet evropiane. Këto zhvillime mbështesin gjithashtu efikasitetin në pagesat ndërkufitare, duke ulur kostot dhe duke rritur likuiditetin për bizneset që veprojnë brenda rajonit dhe me BE-në.

Për të avancuar më tej kapacitetet tona institucionale, BQK-ja me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, përmes programit TAIEK, ka nisur procesin për krijimin e një sistemi të specializuar për parandalimin dhe luftimin e falsifikimit të parasë, në bashkëpunim me institucionet kryesore për zbatimin e ligjit.

Prandaj, ruajtja e integritetit të euros në Kosovë është një prej përgjegjësisëve më të rëndësishme të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Pavarësisht mungesës së monedhës kombëtare, ne kemi ndërtuar një qasje të plotë, që kombinon stabilitetin financiar, kontrollin mbi paranë fizike, digjitalizimin e shërbimeve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Këta hapa tregojnë qartë se, edhe pa një monedhë kombëtare, BQK-ja ka ndërtuar një sistem të fuqishëm për ruajtjen e integritetit të euros, për parandalimin e informalitetit dhe falsifikimeve dhe për garantimin e stabilitetit financiar në Kosovë. Përveç

aspektit ligjor dhe institucional, ne gjithashtu po zhvillojmë infrastrukturën e pagesave digjitale dhe mekanizmat për pagesa ndërkufitare, duke siguruar që qytetarët dhe bizneset të përfitojnë nga shërbime moderne, të sigurta dhe të shpejta.

Në fund, ky kombinim i masave rregullative, teknologjike, dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, siguron që sistemi ynë financiar të jetë jo vetëm modern dhe i integruar me standardet evropiane, por edhe i qëndrueshëm dhe rezistues ndaj sfidave të kohës moderne.

GP Magazinë: Cilat janë prioritetet kryesore të BQK-së për të mbështetur rritjen ekonomike përmes financimit të bizneseve vendore?

Ahmet Ismaili: Një nga objektivat ligjore nga Ligji i BQK-së është edhe mbështetja e politikave ekonomike, për atë sa ato përputhen me pikëpamjen dhe qasjen e BQK-së, për të pasur rritje të qëndrueshme që shkon krahas stabilitetit financiar. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës kontribuon në krijimin e një mjedisi financiar të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, që mundëson qasje më të lehtë të bizneseve vendore në financim. Në këtë kuadër, në fokusohemi në disa fusha kryesore.

Promovojmë përfshirjen financiare dhe edukimin financiar, duke kontribuar që bizneset, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të kuptojnë dhe menaxhojnë më mirë mundësitë e tyre financiare. Kjo arrihet përmes rishikimit të kornizës ligjore dhe koordinimit të nismave që mbështesin qasjen në financa, duke përfshirë Fondin për Garanci Kreditore. Fondi Kosovar i Garancisë Kreditore është një mjet strategjik për të rritur qasjen e bizneseve në kredi dhe financim për zhvillim, ku BQK-ja ka krijuar një kornizë rregullative që njeh kreditë e garantuara nga Fondi për Garanci Kreditore, duke lehtësuar kërkesat për kapital dhe duke i bërë ato më të përshtatshme për bankat që japin kredi të garantuara, pa kompromentuar stabilitetin financiar.

Gjithashtu promovojmë financimin e investimeve të qëndrueshme, përfshirë projekte të gjelbra dhe efikasitetit energjetik, duke synuar që rritja ekonomike të jetë jo vetëm e shpejtë, por edhe e qëndrueshme.

Rasti i kornizës së financimit të përbashkët përmes kredive të sindikuara është një nga ata shembuj që mundëson financim të duhur, ndërsa kujdeset të mos këtë koncentrim të rrezikut në një institucion të vetëm. Por të mos harrojmë se siguri i stabilitetit financiar dhe mbikëqyrja prudenë është një premisë themelore për zhvillimin e kreditimit edhe për investimet afatgjata të bizneseve, prandaj, në çdo rast, ai është prioriteti ynë.

GP Magazinë: Sa i përgatitur është sektori bankar për t'i mbështetur startup-et, ndërmarrjet e vogla dhe inovacionin në ekonomi?

Ahmet Ismaili: Sektori bankar në Kosovë ka bërë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të një mjedisi që mbështet startup-et dhe ndërmarrjet e vogla. Bankat janë të gatshme të ofrojnë kredi dhe financim për projekte të reja, veçanërisht përmes instrumenteve të garancisë, si bashkëpunimi me Fondin Kosovar të Garancisë Kreditore, që ul rrezikun për bankat dhe rrit qasjen e bizneseve në kapital. Së fundi, nisma e udhëhequr nga BQK-ja për financimin e grave ndërmarrëse në biznes (WE Finance Code) me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim është një rast i tillë, krahas asaj që po ashtu ka mbështetur BQK-ja, ku Fondi për Garanci Kreditore ka rishikuar kushtet e financimit për kategorinë e tillë, duke siguruar më shumë mbështetje dhe siguri për kthimin e kredisë, ndërsa ka lehtësuar edhe kushtet dhe tarifatat që ndikojnë pozitivisht te bankat për të lehtësuar dhe për të rritur kreditimin, pa cenuar standardet e caktuara.

Për më tepër, BQK-ja ka krijuar një kornizë rregullative, e cila lehtëson kërkesat për kapital për kreditë e garantuara dhe inkurajon financimin e projekteve inovative. Bankat, gjithashtu, po investojnë në zhvillimin e njohurive të tyre mbi startup-et dhe NVM-të, duke ofruar këshillim dhe mbështetje për marrjen e kredive të përshtatshme.

BQK-ja i jep një rëndësi të veçantë digjitalizimit dhe zhvillimit teknologjik në sektorin financiar. Përveç ndërtimit të infrastrukturës, ne promovojmë edukimin financiar, me qëllim të rritjes së përdorimit të platformave digjitale të pagesave dhe të vetëdijes mbi rreziqet e sigurisë kibernetike. Kjo përmasë edukative është po aq e



rëndësishme sa infrastruktura, sepse siguron adoptimin e shërbimeve të reja dhe menaxhimin e qëndrueshëm të rrezikut. Në këtë kuadër, BQK-ja po bashkëpunon ngushtë me partnerë ndërkombëtarë, si Banka Botërore dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC). Projekti i përbashkët, që do të vazhdojë deri në fund të vitit 2027, synon të transformojë mjedisin e shërbimeve digjitale dhe të pagesave në Kosovë, duke rritur përfshirjen financiare, ulur kostot e pagesave dhe zhvilluar shërbime digjitale në përputhje me standardet evropiane.

Në përmbledhje, sektori bankar është i përgatitur dhe i gatshëm, por edhe në zhvillim e sipër, duke ofruar zgjidhje më të personalizuar dhe fleksibile për startup-et, ndërmarrjet e vogla dhe inovacionin, brenda një ekosistemi modern, digjital dhe të qëndrueshëm.

GP Magazinë: A ka pasur rritje të investimeve të huaja në 4 vitet e fundit përmes sektorit financiar dhe cilët janë trendët që po i vëreni?

Ahmet Ismaili: Investimet e Huaja Direkte në Kosovë kanë shënuar një rritje të qëndrueshme gjatë viteve të fundit, dhe në vitin 2024 arritën 793.5 milionë euro, pothuajse duke u dyfishuar brenda katër vjetësh. Ky trend vazhdoi edhe në vitin 2025 dhe gjatë tetë muajve të parë të vitit IHD-të arritën në 632.3 milionë euro, duke reflektuar një interes të fortë të investitorëve të huaj.

Një element kyç mbetet niveli i lartë i investimeve në sektorin e pasurive të paluajtshme, i cili vazhdon të përbëjë mbi 80% të totalit të IHD-ve. Ndërsa, ky sektor siguron fluks të qëndrueshëm kapitali, dominimi i tij evident tregon një mungesë të diversifikimit sektorial, ku sektorë të tjerë, përfshirë financat, teknologjinë dhe industrinë, mbeten

me pjesëmarrje të kufizuara.

Ky trend i qëndrueshëm tregon besimin e vazhdueshëm të investitorëve në tregun tonë dhe një mundësi për autoritetet të nxisin investime më të larmishme, duke krijuar një bazë më të qëndrueshme për zhvillimin e ekonomisë sonë.

Megjithatë, largimi i Republikës së Kosovës nga lista e vendeve fragjile dhe konflikuale të Bankës Botërore dhe FMN-së, ku BQK-ja pati rol të rëndësishëm, krahas vlerësimit të parë sovran kreditor përben një element shtesë që mund të ndikojë në ambientin për rritjen e investimeve të huaja. Kjo megjithatë mund të ndikohet edhe nga faktorët e jashtëm të natyrës gjeopolitike dhe ekonomike, krahas dinamikës dhe qëndrueshmërisë institucionale, si faktorë të brendshëm.

GP Magazinë: Sa e qëndrueshme është ekonomia e Kosovës përballë krizave globale, si inflacioni, luhatjet e çmimeve të energjisë, apo tensionet gjeopolitike?

Ahmet Ismaili: Që nga viti 2020, kur ishte një test shumë serioz nga ndikimi i pandemisë COVID-19, ekonomia e Kosovës ka treguar aftësi të forta për t'u përballur me sfida të ndryshme globale. Pas ndikimit të pandemisë, në vitin 2021 ekonomia u rikuperua me një rritje reale prej 10.7%, një nivel jashtëzakonisht i lartë, duke treguar elasticitetin e aktivitetit ekonomik.

Në vitet pasardhëse, pavarësisht krizës në Ukrainë dhe luhatjeve të çmimeve të energjisë, si dhe presioneve inflacioniste, ekonomia ka vazhduar të rritet në mënyrë të qëndrueshme: 4.3% në 2022, 4.1% në 2023 dhe 4.6% në 2024. Në terma nominalë, BPV-ja u rrit nga 796 miliardë euro në vitin 2021 në 10.35 miliardë euro në vitin 2024.

Kjo performancë tregon se

ekonomia e Kosovës ka rezistencë ndaj krizave globale, duke ruajtur stabilitet financiar dhe likuiditet të mjaftueshëm në sistemin bankar, ndërkohë që inflacioni dhe çmimet e energjisë janë menaxhuar me kujdes nga politikat monetare dhe fiskale. Megjithatë, sfidat strukturore mbeten, përfshirë nevojën për diversifikim të investimeve dhe forcim të sektorëve ekonomikë përtej pasurisë së paluajtshme, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar.

Prandaj, edhe angazhimet tona të fundit në nivel të sektorit financiar kanë qenë të drejtuara kah rritja e kapaciteteve për përgjigje ndaj situatave të krizës apo shokut financiar, duke përfshirë vendosjen e shtesave të kapitalit për bankat, rritjen e premiumit të depozitave që paguajnë bankat në Fondin e Sigurimit të Depozitave, si dhe masave tjera që kanë kontribut në stabilitetin e sektorit financiar. Kjo qasje është në linjë me praktikatat e vendeve të BE-së, si dhe është bërë në konsultim me partneret tanë ndërkombëtarë.

GP Magazinë: Si e shihni BQK-në në kontekst rajonal, a po afrohet me standardet financiare dhe bankare të vendeve të BE-së?

Ahmet Ismaili: BQK-ja po avancohet në mënyrë të qëndrueshme drejt harmonizimit të sistemit financiar dhe bankar me standardet e Bashkimit Evropian. Ne po e fuqizojmë kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse për t'u përputhur me legjislacionin dhe praktikatat evropiane, në linjë me udhëzimet e EBA-së, BQE-së dhe standardet e Bazeli-it. Reformat për rritjen e stabilitetit financiar, përfshirë vendosjen e shtesave makroprudenciale dhe procesin SREP, si dhe avancimet drejt Solvency II dhe IFRS 17, tregojnë qartësisht orientimin tonë drejt standardeve të BE-së. Po ashtu, avancimi në menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore përmes CBAM dhe projekteve për Green Bonds dhe Green Taxonomy e vendos Kosovën në një rrugë proaktive të financiarizimit të qëndrueshëm.

Në fushën e teknologjisë dhe sigurisë digjitale, rregullat për menaxhimin e sistemeve informacioni dhe rrezikut kibernetik, të harmonizuara me PSD2 dhe DORA, tregojnë adaptimin e Kosovës me standardet evropiane. Sa u përket

pagesave dhe infrastrukturës digjitale, kemi përparuar me Ligjin për shërbimet e pagesave, lidhjen me TIPS, projektet e eKYC, Open Banking dhe digjitalizimin e regjistrave bankarë, përfshirë edhe para-aplikimin në SEPA, duke përmirësuar kështu shërbimet për qytetarët dhe bizneset.

Po ashtu, miratimi i Rregullores për Licencimin e Operatorëve të Kripto-Aseteve, avancimi i mbrojtjes së konsumatorit dhe zbatimi i udhëzimeve për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit tregojnë orientimin e BQK-së drejt praktikave më të mira evropiane dhe standardeve ndërkombëtare. Në përmbledhje, BQK-ja po e vendos Kosovën në një rrugë të qartë drejt integritit gradual dhe të qëndrueshëm me sistemin financiar evropian, që paraqet një mundësi shumë të mirë, krahas apo paralelisht me procesin e zgjerimit dhe konvergjencës me vendet e BE-së.

GP Magazinë: Cili është mesazhi juaj për investitorët ndërkombëtarë që po e shohin Kosovën si një treg në zhvillim?

Ahmet Ismaili: Kosova ofron një sistem financiar të qëndrueshëm, profitabil dhe të kapitalizuar mirë, me nivele të larta likuiditeti dhe menaxhim të kujdesshëm të rreziqeve. Bankat dhe institucionet financiare operojnë nën mbikëqyrje të rreptë të BQK-së, duke garantuar stabilitet dhe transparencë për të gjithë aktorët e tregut. Niveli i kredive performuese është model për gjithë rajonin, me vetëm 2% kredi joperformuese. Sistemi i fortë bankar, krahas politikave të tjera tatimore, si dhe atyre që mbrojnë investitorët e huaj, është faktor i rëndësishëm në vendimmarrjen për investim në një vend. Veçanërisht ekzistenca e bankave të huaja, me theks që vijnë nga Bashkimi Evropian, përbën një element shtesë pozitiv në këtë aspekt.

Në anën e kornizës ligjore dhe rregullative, ne po e harmonizojmë atë me praktikatat e Bashkimit Evropian, duke përfshirë kapitalizimin, mbrojtjen e konsumatorit dhe menaxhimin e rreziqeve. Ligjet e reja për bankat dhe shërbimet e pagesave, si dhe përforcimi i mbikëqyrjes, e bëjnë tregun financiar më të besueshëm dhe të parashikueshëm.

Ekonomia e Kosovës ka treguar rritje të qëndrueshme edhe gjatë periudhave sfiduese dhe sektori

financiar po mbështet startup-et, ndërmarrjet e vogla dhe inovacionin, duke krijuar mundësi reale për investime të sigurta dhe me potencial të lartë kthimi.

Projekte si SEPA, TIPS dhe modernizimi i infrastrukturës së pagesave rrisin integritimin tonë me ekonominë evropiane dhe tregjet ndërkombëtare, duke e bërë Kosovën një treg të hapur dhe të lehtë për biznes. Në fund, në aspektin e fushëveprimit të BQK-së, përforcimi i qeverisjes, respektimi i standardeve AML/CFT dhe angazhimi për financa të qëndrueshme tregojnë seriozitetin tonë në menaxhimin e riskut dhe në krijimin e një mjedisi të besueshëm për investitorët ndërkombëtarë. Kjo krahas partneriteteve dhe përfaqësimeve që kemi në forume dhe panele të ndryshme ndërkombëtare, që kontribuojnë në njohjen sa më të mirë të këtyre mundësive.

GP Magazinë: A mendoni se Kosova mund të shndërrohet në një qendër të shërbimeve financiare dhe inovacioneve digjitale në rajon?

Ahmet Ismaili: Kosova luan një rol të rëndësishëm dhe ka potencial të madh për t'u bërë një qendër rajonale e shërbimeve financiare dhe inovacioneve digjitale. Sektori i teknologjisë informatike (ICT) dhe FinTech, si dhe ai i shërbimeve profesionale në veçanti, përbën një mundësi unike për investim, që bazohet në fuqinë punëtore konkurruese dhe profesionale, moshën e re të popullsisë, që është e hapur ndaj digjitalizimit dhe gjuhëve të huaja, krahas legjislacionit mbështetës ndaj investitorëve dhe politikave tatimore të favorshme.

Sektori bankar dhe institucionet e tjera financiare janë mirë të konsoliduara, të rregulluara dhe të mbikëqyrura sipas praktikave të vendeve të Bashkimit Evropian. Reformat mbi integritetin e monedhës euro, avancimi i infrastrukturës së pagesave të integruara në SEPA dhe TIPS, zhvillimi i tregut të kapitalit, siguri i depozitave dhe Fondi për Garanci Kreditore, përparimet digjitale, zhvillimi i kripto-aseteve, si dhe fokusimi mbi edukimin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit krijojnë kushtet e duhura për Kosovën të shndërrohet në një qendër të shërbimeve financiare dhe inovative.

Unë jam Radio Dukagjini

një zë që udhëton me ju, në tokë dhe në ajër

Çdo mëngjes, çdo mbrëmje, çdo orë e natës – që nga viti 1999, zëri im është bërë pjesë e jetës në Kosovë. Fillova si një radio lokale, por që nga viti 2001 u rrita në një radiostacion kombëtar. Vetëm një vit më pas, sipas sondazhit të Agjencisë amerikane IREX, u vlerësova si radio më e dëgjuar në Kosovë – dhe këtë dashuri e besim e ruaj edhe sot, me po aq përkushtim.

Unë jam një përzierje e përvojës dhe rinisë. Kam njerëz që kanë qenë me mua që në ditët e para dhe të rinj plot pasion. Programi im është i ndarë në pesë sektorë të qartë: lajme, zbavitje, muzikë, shitje dhe administratë, si dhe produksion. Gjithçka që dëgjoni, është punë zemre dhe profesionalizmi.

Sot, më dëgjojnë jo vetëm në frekuencat tokësore në tërë Kosovën, por edhe online, nga bashkatdhetarët në mërgatë e dëgjues të rinj kudo në botë. Falë teknologjisë dhe aplikacionit tim që mban emrin tim – Radio Dukagjini – jam vetëm një klikim larg.

Më gjeni në këto frekuenca:

99.7 FM – Prishtinë e rrethinë

94.5 FM – Rajoni i Dukagjinit dhe Prizrenit

105.1 FM – Rajoni i Mitrovicës dhe Kamenicës

104.7 FM – Rajoni i Pejës dhe Podujevës

92.7 FM – Rajoni i Gjilanit, Kamenicës dhe Prishtinës

93.2 FM – Rajoni i Kaçanikut

Dhe gjithashtu në të gjitha rrjetet sociale. Mjafton të kërkon "Radio Dukagjini". Nuk do të isha këtu pa ju. Pa dëgjuesit, bashkëpunëtorët, dhe të gjithë ata që më besuan rrugës. Kam shënuar 25 vjet jetë – një çerek shekulli që flet për përkushtim, dashuri për radion, dhe një komunitet që nuk ndalet së bashkëjetuari me fjalën dhe muzikën.

Sepse gjërat e mëdha ndodhin kur bashkëveprojmë.

Me dashuri nga Radio Dukagjini, zani që ju ndjek.



radio
dukagjini

☎ 038 737 373 ☎ 038 737 374

📠 043 777 022 (marketing)

✉ radio@dukagjini.com

POLITIKO

ME KUSHTRIM SADIKUN

E HËNË - E ENJTE
20:20

NË KANAL 10

“Politiko” me Kushtrim Sadiku është një emision debatues informativ që trajton zhvillimet më të rëndësishme politike, ekonomike dhe shoqërore në vend.

Në studion e gazetarit **Kushtrim Sadiku** mbledhen personalitete publike, përfaqësues institucionesh, analistë dhe njohës të fushave përkatëse, duke ofruar diskutim të drejtpërdrejtë dhe këndvështrime diverse dhe të balancuar mbi temat aktuale.

Në një platformë unike e ekskluzive me shikueshmëri rekorde, përmes analizave të detajuara dhe ballafaqimit të argumenteve, shikuesit kanë mundësi të krijojnë një pasqyrë më të qartë mbi çështjet që ndikojnë jetën publike dhe vendimmarrjen në Kosovë dhe rajon.



VENERA RADA, GRUAJA QË RIGJEN VETEN NË PRIZREN

Në rrugicat e ngushta të Prizrenit, aty ku guri ruan kujtesën e shekujve dhe ku Hamami i qytetit ende frymon histori, gjendet një hapësirë e vogël që mban brenda saj histori të mëdha. Nuk ka dritare të mëdha, as tabela të zhurmshme, por ka duar që punojnë, gra që flasin, qeshin, reflektojnë dhe krijojnë.



Kjo është hapësira e “STEP”, organizata e drejtuar nga Venera Rada, një grua që jetën e saj e ka kthyer në proces rindërtimi, ashtu si materialet që gratë i shndërrojnë në art.

Rruga e saj nuk ka qenë lineare. Ajo kishte filluar studimet për mjekësi, por jeta i kishte plane të tjera. “Kam arritur në vitin e fundit në mjekësi, por më kanë mbetur edhe shtatë provime pa i përfunduar. Ai është dështimi im dhe brenga ime, sepse krejt çka kam planifikuar nuk kam mujt me realizu”, thotë Venera pa e zbukuruar të kaluarën. Por, ajo që dukej si fund u shndërrua në një kthesë të heshtur.

Kur fëmijët u rritën dhe koha e lirë filloi të bëhej barrë, ajo e kuptoi





se mungesa e angazhimit po i zbrazte ditët nga kuptimi. “Nuk më dukej interesant me shku nëpër shtëpi veç me njëjtë e me pi kafe. Nuk më plotësonte. E pyesja veten vazhdimisht: çka bëj unë tash?”, kujton ajo. Një natë, duke parë një film, një

detaj i vogël e vuri në lëvizje. “Personazhi kishte gjithçka, por diçka i mungonte. Kur filloi me shku në kurs vallëzimi, ia shtoi jetës një risi. Aty thashë: edhe unë duhet me ndryshu diçka.”

Kërkimi e çoi fillimisht në kurse që nuk e bindën

menjëherë. “Fillova me kursin e bizhuterisë, as që më interesonte në fillim. Nuk e dija që ka me fillu me më pëlqy”, thotë ajo me buzëqeshje. Kurset përfunduan, por prej tyre lindi diçka më e madhe, një shoqatë që sot njihet si STEP.

Një trajnim intensiv për punë dore në Turqi ia kristalizoi idenë që e udhëheq ende sot. “Aty e kuptova që grave, pa marrë parasysh a janë të shkolluara apo jo, u duhet një mbështetje e madhe. Ju duhet diçka me u marrë, diçka e tyne”, shprehet Venera. Kështu, në një hapësirë të vogël pranë Hamamit të Prizrenit, filluan të mblidhen gra që kërkonin më shumë se një zanat.





Në STEP, ato mësojnë pirografi- djegie në dru, relief dhe filigran në letër, si dhe ngjyrosje në materiale të ndryshme si druri, porcelani dhe tekstili. Por zanati është vetëm një pjesë e procesit. “Nuk është puna veç te zanati. Edhe socialja ka shumë rëndësi. Gratë kanë një arsye me dalë prej shtëpisë, me ardhë me punu, me kalu një kohë të mirë dhe produktive, e në fund del një punim i tyne”, thotë ajo.

Grupet përbëhen deri në 15 gra dhe kurset janë falas. Orari përshtatet me realitetin e tyre. “Zakonisht punojmë pasdite ose mbrëmje, sepse gratë duan me i kry punët e shtëpisë, e ato që punojnë e kanë ma të lehtë në këtë orar. Çdo grua mundet me u bashku, mjafton me na shkru në Facebook të STEP-it”, shpjegon Venera. Për momentin, pjesëmarrëset janë kryesisht nga Prizreni, pasi transporti mbetet një sfidë për shtrirjen në rrethinë.

Sfida më e madhe mbetet mbështetja financiare. “Grantet dhe mbështetjet janë sfida jonë kryesore. Materiali është i kushtueshëm, edhe hapësira ku



mbahen kurset. Kur mbështetja mungon, ne riciklojmë vazhdimisht dhe gratë janë shumë të gatshme me ndihmu”, thotë ajo. Materialet mbeten falas dhe çdo produkt i punuar u takon grave që e kanë krijuar.

Punimet nuk mbesin vetëm brenda mureve të STEP-it. Ato udhëtojnë. Shoqata ka marrë pjesë në panaire në Prizren, Prishtinë, Tetovë dhe Sarandë. “Ne i mbledhim gratë dhe shkojmë bashkë në panaire. Aty ato i shesin produktet e veta dhe e shohin që puna e duarve të tyre ka vlerë”, thotë Venera, e bindur se ky moment është po aq i rëndësishëm sa vetë procesi i krijimit.

Sot, ajo është edhe trajnuese e pirografisë në programet e Komunës së Prizrenit. Por, përtej titujve, Venera Rada mbetet shembull i një rruge që nuk u mbyll kur një ëndërr u ndërpre, por u hap në një drejtim tjetër. Në rrugicat e vjetra të Prizrenit, ajo ka ndërtuar një hapësirë ku gratë nuk djegin vetëm dru, ato djegin dyshimet, frikën dhe heshtjen, duke krijuar diçka që u përket atyre.





BANESË MODERNE PRANË DETIT ZGJEDHJE IDEALE PËR 2026

Kompleksi rezidencial “Viena”, projekt i Bonita Konstruksion, po zhvillohet në një nga zonat më të kërkuara të Golemit, duke ofruar apartamente moderne të konceptuara për jetesë komode dhe investim të qëndrueshëm. Planimetri funksionale, ndriçim natyral dhe arkitekturë bashkëkohore krijojnë ambiente të përshtatshme si për familje, ashtu edhe për përdorim sezonal.

Ndërtimi realizohet me standarde të larta teknike, materiale cilësore dhe izolim të mirë, duke garantuar rehati gjatë gjithë vitit. Pozicioni pranë detit dhe kërkesa e lartë turistike e zonës e bëjnë “Vienën” një mundësi reale për të ardhura nga qiratë afatshkurtra.

Për vitin 2026, Bonita Konstruksion ofron çmime speciale, skema pagese fleksibël dhe mundësi personalizimi të ambienteve të brendshme, duke i shtuar vlerë çdo apartamenti.

Një projekt që bashkon banimin modern me investimin e mençur.

KOMPLEKSI “VIENA” – GOLEM

Tel & WhatsApp: **+355 69 238 6456**

BONITA KONSTRUKSION

Ndërtojmë cilësi, krijojmë vlerë.





“ORËT E D-DAY”, TË PUNUARA NGA HELMETAT E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Ora e re Normandie, e vitit 1944, është prodhuar nga helmetat dhe çantat e shpinës së ushtarëve të Luftës së Dytë Botërore, si dhe nga rëra e plazheve të Normandisë.

**“Maroussia Productions” për
“Col&MacArthur”.**

Në një epokë kur orët gjenden pothuajse në çdo xhep dhe në çdo ekran, pika kryesore e shitjes për prodhuesin e orëve “Col&MacArthur” nuk është vetëm koha, por vetë historia.

I njohur për përdorimin e materialeve të pazakonta - nga uji i Pearl Harbor-it te pluhuri i meteoritëve hënorë - në shërbim të rrëfimit orologjik, marka tani po përkujton zbarkimet e D-Day me një seri orësh të prodhuara nga helmetat dhe çantat e shpinës së ushtarëve amerikanë, si dhe nga





rëra e plazheve të Normandisë.

“Njerëzit nuk po e blejnë këtë orë sepse tregon kohën”, tha drejtori ekzekutiv i kompanisë, Sébastien Colen, gjatë një telefonate nga Belgjika, ku ish-drejtuksi i sektorit të energjisë bashkëthemeloi kompaninë në vitin 2013. “E blejnë sepse i kthen diku në të kaluarën.”

Colen kaloi tre vjet duke zhvilluar një prototip për Normandie 1944, një orë luksoze që përmban metal nga helmata M-1, helmata standarde e ushtrisë amerikane gjatë Luftës së Dytë Botërore. E siguruar nga një shtëpi ankandesh në Dallas, Teksas, helmata u rrafshua me presë - jo me çekiq - për të ruajtur shenjat dhe papërsosmëritë origjinale. Fleta metalike e përfutur më pas u pre në forma rrethore, të cilat përdoren në fushat (dialekt) e orëve dhe vendosen në kasat 43-milimetërshe në studion e markës në Liège, Belgjikë.

“Col&MacArthur” i siguroi helmata nga një tregtar antikitetesh i specializuar në objekte ushtarake.

Pjesët prodhohen vetëm pas porosisë, që do të thotë se numri i helmatave të nevojshme varet nga sa orë shiten. (Një helmata M-1 përmban mjaftueshëm metal për “rreth 20” orë, tha Colen.) Aktualisht, prodhuesi i orëve po pranon porosi përmes një fushate në Kickstarter, e cila në momentin e publikimit kishte mbledhur mbi 86,000 dollarë.

Në pjesë të tjera të dizajnit përfshihet një kapsulë e vogël me rërë nga Normandia dhe një rrip i bërë nga çanta e shpinës M-1928, e përdorur gjerësisht nga ushtria amerikane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fusha e orës shfaq një hartë historike të Omaha Beach, emri kod i njërit prej pesë sektorëve të zbarkimit - krahas Utah, Gold, Juno dhe Sword - të përdorur nga trupat aleate në D-Day.

Në vitet që pasuan, prodhuesi

i orëve publikoi koleksione të bazuara në më shumë se një duzinë temash, nga Leonardo da Vinci te Beteja e Britanisë. Shumë prej tyre përmbajnë artefakte “të prekshme”, përfshirë pluhur hënë nga një meteorit hënor (i përdorur në orë kushtuar misionit Apollo 11) dhe ujë nga Pearl Harbor (i mbyllur mes kristaleve safiri në orë që përkujtojnë sulmin japonez mbi bazën detare amerikane në vitin 1941).

Nëse fushata e fundit e financimit tejkalon 100,000 dollarë, “Col&MacArthur” do të fillojë të investojë në koleksionin e radhës: orë që përkujtojnë Betejën e Bulge, fushata e fundit e Gjermanisë naziste në Frontin Perëndimor. Colen planifikon të përfshijë fragmente të një predhe, të hedhur mbi qytetin belg Bastogne, në dizajnin e orëve.

“Për çdo orë të vetme, ne përpiqemi vërtet të integrojmë diçka unike”, tha ai.



ËNDËRRAT DHE MUNDËSITË E REJA **PËR TË EKSPLORUAR** **ME GP AVIATION**

Udhëtimi nga Kosova drejt Evropës po bëhet më i afërt, më i lehtë dhe më i larmishëm se kurrë më parë. Qytetarët e Kosovës tashmë kanë në dispozicion pesë mundësi të reja për të eksploruar qytete ikonike evropiane, falë zgjerimit të rrjetit të fluturimeve direkte nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.



Nga eleganca perandorake e Vjenës, te ritmi urban i Milanos, nga qetësia alpine e Salzburgut deri te dinamika politike e Brukselit dhe natyra mahnitëse e Oslos, këto destinacione të reja hapin horizonte të reja për turizëm, biznes dhe lidhje familjare.

Këto linja të reja ajrore nuk përfaqësojnë vetëm shtim

destinacionesh në hartë, por një hap të rëndësishëm drejt rritjes së mobilitetit dhe integritit evropian për qytetarët e Kosovës. Me nisjen e operimeve nga muaji mars, udhëtimi drejt këtyre qyteteve do të jetë më i shpejtë, më komod dhe më i qasshëm, duke i kthyer ëndrrat e shumë udhëtarëve në plane konkrete.

Viti 2025 shënon një moment historik për GP Aviation. Me mbi 1.4 milionë pasagjerë të transportuar deri në fund të muajit tetor, kompania ajrore ka arritur rekordin më të lartë që nga themelimi i saj, duke u pozicionuar si një nga operatorët më të rëndësishëm dhe më dinamikë në tregun e aviacionit në Kosovë dhe rajon.

DESTINACIONET E REJA – PSE DUHET T’I VIZITONI?



VJENË – ELEGANCË PERANDORAKE DHE KULTURË PA KOHË

Pse ta vizitoni?

Vjena është kryeqyteti i muzikës klasike, artit dhe arkitekturës madhështore. Pallatet perandorake, muzetë botërorë dhe kafenetë tradicionale e bëjnë atë një destinacion ideal si për turizëm kulturor, ashtu edhe për udhëtime biznesi. Me linjën direkte nga Prishtina, Vjena bëhet më e afërt se kurrë.



SALZBURG – QYTETI I ALPEVE DHE I MOZARTIT

Pse ta vizitoni?

I rrethuar nga Alpet dhe i njohur si vendlindja e Mozartit, Salzburg ofron një kombinim perfekt mes natyrës, historisë dhe kulturës. Është destinacion ideal për pushime të qeta, dashamirë

të muzikës dhe adhurues të peizazheve alpine.



MILANO (BERGAMO) – KRYEQYTETI I MODËS DHE STILIT

Pse ta vizitoni?

Milano është zemra e modës, dizajnit dhe biznesit italian. Nga pasarelat botërore deri te arkitektura moderne dhe kuzhina italiane, qyteti ofron energji urbane dhe elegancë mesdhetare. Aeroporti i Bergamos e bën këtë destinacion edhe më të qasshëm për udhëtarët.



BRUKSEL – KRYEQYTETI I EVROPËS

Pse ta vizitoni?

Brukseli është qendër politike,

diplomatike dhe kulturore e Bashkimit Evropian. Përveç institucioneve evropiane, qyteti ofron arkitekturë unike, çokollatë të famshme dhe një skenë gastronomike shumëngjyrëshe. Ideale për udhëtime zyrtare dhe turistike.



OSLO – NATYRË SKANDINAVE DHE MODERNITET

Pse ta vizitoni?

Oslo kombinon teknologjinë moderne me natyrën e paprekur. Fjordet, muzetë bashkëkohorë dhe cilësia e lartë e jetesës e bëjnë këtë qytet një destinacion të veçantë për eksplorim urban dhe natyror.

DOKTORI KOSOVAR QË U ZHVILLUA NË GJERMANI RIKTHEHET NË VENDLINDJE

Në një kohë kur shumë profesionistë të shëndetësisë vazhdojnë të kërkojnë të ardhmen jashtë vendit, historia e Dr. Kujtim Pllanës përbën një shembull frymëzues të kthimit, përkushtimit dhe dashurisë për atdheun.

Anesteziolog me përvojë të gjerë profesionale në Gjermani, Dr. Pllana ka vendosur ta sjellë dijen dhe përvojën e tij aty ku gjithçka nisi – në Kosovë.

Dashuria për mjekësinë nuk ishte një zgjedhje e rastësishme. Ajo lindi herët, brenda familjes.

“Kam vendosur të studioj mjekësi për shkak të idealizimit të këtij profesioni në familjen time dhe sepse edhe nëna edhe babai janë nga fusha e mjekësisë”,

tregon Dr. Pllana, duke e lidhur rrugëtimin e tij profesional me rrënjët familjare dhe vlerat e trashëguara.

Pas përfundimit të studimeve, realiteti në Kosovë rezultoi sfidues. Mundësitë për punë dhe specializim ishin të kufizuara, çka e shtyu atë të marrë rrugën e emigrimit drejt Gjermanisë.

“Pas studimeve nuk kishte mundësi pune dhe as specializimi, prandaj vendosa të shkoj në Gjermani, si një mundësi për t’u specializuar dhe për të ndërtuar karrierën”,



kujton ai.

Vendimi për të emigruar nuk ishte i lehtë, por ishte i domosdoshëm. Sistemi shëndetësor gjerman ofronte kapacitete akademike dhe profesionale që Kosova ende nuk i kishte.

“Arsyet e largimit kanë qenë të përziera, por kryesisht mungesa e mundësive dhe kapaciteteve që ofron sistemi arsimor dhe shëndetësor gjerman”.

Në Gjermani, Dr. Pllana ndërtoi një karrierë të suksesshme, duke punuar në institucione të njohura

shëndetësore si SÜdharz Hospital Nordhausen, St. Georg Klinikum Eisenach dhe Universitätsklinikum Jena (UKJ) – një nga qendrat më të mëdha në Evropë për trajtimin e sepsës. Pikërisht aty ai u formësua më tej si anesteziolog dhe mjek i kujdesit intensiv, një fushë ku çdo vendim ka peshën e jetës.

“Siç e them shpesh, puna jonë është vetë sfida, sidomos në kujdesin intensiv, ku si mjek jeton mes jetës dhe vdekjes”.

Megjithatë, pavarësisht suksesit profesional, diçka mungonte. Ajo quhej vendlindje.

“Vendosa të kthehem për arsye të thjeshta: këtu kam lindur dhe jam rritur, ky është vendi im. Këtu i kam prindërit dhe dua të sjell një përvojë ndryshe nga Gjermania. Vendimi është më shumë emocional sesa logjik”, shprehet ai.

Kthimi i tij nuk është vetëm një akt personal, por edhe një mesazh shprese për shumë mjekë të tjerë shqiptarë në diasporë.

“Besoj se ka shumë mjekë që janë në proces të kthimit ose tashmë janë kthyer. Ky është vendi ynë. Jeta për ne është më interesante këtu dhe shpresoj që të kthehen edhe shumë të tjerë, sepse do të ishte shumë mirë për këtë vend”.

Me etikë të lartë profesionale, Dr. Pllana thekson gjithmonë respektin ndaj pacientëve dhe kodit mjekësor.



“ Sot, prania e tij në Kosovë është më shumë sesa një kthim fizik – është një investim në njerëz, në sistem dhe në të ardhmen e shëndetësisë kosovare. Historia e Dr. Kujtim Pllanës dëshmon se, pavarësisht sfidave, kthimi është i mundur dhe se përvoja ndërkombëtare, kur bashkohet me dashurinë për vendin, mund të sjellë ndryshim real.



20 VENDET MË TË MIRA PËR TË UDHËTUAR NË VITIN 2026

Në këshillat dhe rekomandimet për vizitorët, mediumi publik, Britanez BBC, ka renditur edhe listën e vendeve të rekomanduara për t'u vizituar gjatë vitit 2026.

Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe

Abu Dhabi po bëhet një qendër kulturore dhe argëtimi me muzeume të reja, si Zayed National Museum dhe Guggenheim Abu Dhabi, si dhe parqe tematike të zgjeruara në Yas Island, që ofrojnë atraksione për familje dhe adhurues të filmave.

Algjeria

Algjeria kombinon rrënoja romake madhështore, peizazhe surrealistë të shkretëtirës dhe qytete historike si Constantine dhe Timgad, duke ofruar një eksperiencë autentike turistike pa turmat tipike.

Lugina Colchagua, Kili

Lugina Colchagua është një destinacion i mrekullueshëm për dashamirësit e verës dhe natyrës, me estate të njohura si Viu Manent dhe Clos Apalta, ku mund të shijoni degustime, vila moderne dhe aktivitete rurale në mes të peizazheve malore dhe lumore.

Ishujt Cook, Polinezi

Rarotonga dhe ishujt përreth ofrojnë një kombinim unik të bukuri natyrore, kulturës polineze

dhe luksit të relaksuar, ku vizitorët mund të eksplorojnë ishuj të largët dhe të ndihen të mirëpritur si pjesë e komunitetit lokal.

Kosta Rika

Kosta Rika kombinon pyje tropikale, plazhe të bukura dhe mbrojtje të biodiversitetit, duke lejuar vizitorët të ndihen të lidhur me natyrën, ndërsa mbështesin programe konservimi të jaguarëve dhe peshqve emigrantë.

Hebride, Skoci

Ishujt Hebride ofrojnë mikpritje të ngrohtë, plazhe të paprekura, distileri të reja whiskys dhe vende historike, si Calanais Standing Stones, duke i kombinuar traditat e lashta me eksperiencë moderne.

Ishikawa, Japoni

Prefektura Ishikawa ofron kopshtet e famshme Kenrokuen, artizanale tradicionale, si Kaga Yuzen, dhe mundësi për të ndihmuar komunitetet lokale të rindërtojnë pas tërmetit në Noto, duke bashkuar turizmin me përkujdesjen ndaj kulturës dhe natyrës.

Ishujt Komodo, Indonezi

Ishujt Komodo janë shtëpia e Dragons Komodo, ofrojnë peizazhe të paprekura dhe mundësi unike për të parë këtë specie të rrallë në habitatin e saj natyror, ndërsa eksploron ishujt tropikalë.

Loreto, Baja California Sur, Meksikë

Loreto kombinon ujëra të pasura me jetë të egër, ishuj shkretëtire dhe përvoja të udhëhequra nga komuniteti që përfshijnë kayak, shikim balenash dhe festivale konservimi.

Mali i Kotorit, Mali i Zi

Mali i Zi ofron një bregdet spektakolar me gjirin fjord-like të Kotorit, qytete veneciane të ruajtura mirë dhe male dramatike që ftojnë për hiking dhe eksplorim të biodiversitetit.

Bregdeti i Oregonit, ShBA

Bregdeti i Oregonit shtrihet për 370 milje, duke kombinuar plazhe të bardha, pyje të dendura dhe shëtitje të lehta me mundësi të reja për transport elektrik dhe biçikleta.

Oulu, Finlandë

Oulu, kryeqyteti i Kulturës Evropiane 2026, ofron festivale, instalime arti dhe shije nordike-arctike, duke kombinuar natyrën arktike me kreativitetin bashkëkohor.

Filadelfia, ShBA

Filadelfia do të festojë 250-vjetorin e ShBA-së me aktivitete historike, sportive dhe

artistike, duke përfshirë ndeshje të Kupës Botërore, MLB All-Star Game dhe murale të drejtuara nga komuniteti.

Phnom Penh, Kamboxhia

Phnom Penh po rilind me një aeroport të ri ndërkombëtar, rrugë pedonale, tuk-tuk elektrik dhe hapje kreative të hoteleve dhe kafeneve për një eksperiencë të qëndrueshme turistike.

Guimarães, Portugali

Guimarães, vendlindja e Portugalisë dhe kryeqyteti Evropian i Gjelbër 2026, kombinon rrugë mesjetare të ruajtura, trashëgimi kulturore, dhe energji të reja kreative të komunitetit.

Samburu, Kenia

Samburu ofron peizazhe të qeta, kafshë të rralla endemike dhe projekte astroturizmi dhe konservimi që lidhin komunitetin me natyrën.

Santo Domingo, Republika Dominikane

Santo Domingo kombinon plazhe të bardha, restaurime historike dhe festivale muzikore, ndërsa përgatitet për Lojërat Qendrore Amerikane dhe Karaibe 2026.

Lugina Slocan, Britania e Kolumbisë - Kanada


Lugina Slocan ofron bukuri të egër natyrore dhe një shteg 60 km për të nderuar komunitetet japoneze-kanadeze të internuara gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Uluru, Australi

Tetori 2025 shënoi 40-vjetorin e kthimit të Uluru te pronarët tradicionalë Anangu, duke ofruar mënyra të reja dhe më domethënëse për të eksploruar këtë tokë të shenjtë.

Montevideo, Uruguai

Montevideo dhe Uruguai ofrojnë laguna plot flamingo, biftekë të klasës botërore dhe një angazhim të fortë ndaj qëndrueshmërisë dhe respektit për komunitetet lokale.



 **Pristina, Kosovë**

 **+383 44 169 249**

 **+386 49 169 249**

 **binaku_6@hotmail.com**

PRISHTINA ME LAPTOP NË ÇANTË: KU PUNOHET NË KRYEQYTET?

Prishtina nuk është më vetëm një ndalesë tranziti në Ballkan. Është një qytet ku kafeja pihet ngadalë, idetë qarkullojnë shpejt dhe Wi-Fi funksionon pa stres. Një qytet që po mëson ta kombinojë jetën urbane me punën digjitale.

Për ata që udhëtojnë për disa ditë apo javë, për nomadët digjitalë, gazetarët, krijuesit, programerët apo profesionistët që nuk lidhen më me një zyrë fikse, Prishtina ofron gjithnjë e më shumë hapësira co-working që të bëjnë të ndihesh si në punë por me më shumë frymëzim, fleksibilitet dhe jetë rreth teje.

Puna fillon herët, zakonisht me kafe

CoWork iT – Co-working Space-

Për ata që punojnë me ide dhe kafe. Një hapësirë ku laptopët hapen që herët, ku dita nis me fokus dhe vazhdon me biseda profesionale që lindin natyrshëm.

ZenVen (dy lokacione)- Siç e sugjeron edhe emri, ZenVen është vendi ku puna bëhet me qetësi. Me dy lokacione të ndryshme në Prishtinë, kjo hapësirë u përshtatet atyre që kanë nevojë për përqendrim, takime online pa zhurmë dhe një ambient të balancuar mes profesionalizmit dhe rehatisë. Ideale për shkrim, dizajn, planifikim apo ditë pune intensive.

Prishtina Hackerspace- Më shumë se një vend pune, Prishtina Hackerspace është një komunitet. Një hapësirë alternative ku mbledhen mendjet teknologjike, zhvilluesit, inxhinierët dhe krijuesit që duan të ndajnë ide, projekte dhe eksperiencë. Këtu puna nuk është e izoluar është bashkëpunuese, eksperimentale dhe shpesh inovative.

Innovation Centre Kosovo (ICK)- është një shtyllë e zhvillimit të ekosistemit të inovacionit në Kosovë. Më shumë se co-working, kjo është



një qendër idesh, teknologjie dhe zhvillimi, ku startup-et, profesionistët e rinj dhe ekspertët takohen për të ndërtuar projekte me ndikim.

Lavjerrës Culture Café- Lavjerrësi nuk është thjesht një hapësirë pune është një ritëm. Një vend ku puna lëkundet mes fokusit dhe bisedës, mes laptopit të hapur dhe diskutimeve që shkojnë përtej punës. I njohur për frymën komunitare dhe kulturore, Lavjerrësi është ideal për gazetarë, artistë, aktivistë dhe krijues që duan një ambient me kuptim, ku puna dhe jeta ndërthuren natyrshëm.

Loft Coworking Space- Me dizajn modern dhe ndjesi metropolitane, Loft Coworking Space u përshtatet atyre që duan një ambient serioz, por kreativ. Një hapësirë ku profesionalizmi takohet me estetikën urbane perfekte për takime, ditë pune të strukturuar dhe projekte që kërkojnë fokus.

Co-Share- Për ata që besojnë në bashkëpunim. Një hapësirë fleksibile ku rrjetëzimi ndodh natyrshëm dhe ku puna shpesh shndërrohet në ide të përbashkëta. Ideale për profesionistë që nuk duan të punojnë vetëm.

Connect – Coworking & Consulting- Një hapësirë më formale, e përshtatshme për takime serioze, konsulencë dhe prezantime profesionale. Connect ofron një ambient që i përgjigjet nevojave të bizneseve dhe profesionistëve

ndërkombëtarë.

Swiss Innovation Hub- Një qendër që sjell frymë ndërkombëtare dhe standarde zvicerane në ekosistemin lokal. Swiss Innovation Hub është një hapësirë për ide të strukturuar, bashkëpunim profesional dhe projekte që synojnë zhvillim afatgjatë.

Project Space 17- Një hapësirë fleksibile dhe kreative për projekte artistike, kulturore dhe punë individuale. E përshtatshme për ata që kërkojnë një ambient jo-konvencional.

Project Space Sekhmet- Një hapësirë alternative që ndërthur punën kreative me eksperimentimin artistik dhe mendimin kritik. Ideale për krijues që punojnë jashtë kornizave tradicionale.

Newborn Brew- Jo gjithmonë co-working do të thotë zyrë. Për ata që preferojnë të punojnë me laptop nga kafene kreative, Newborn Brew ofron ambient të rehatshëm, energji urbane dhe një ndjesi komunitare ideale për punë të lehta, email-e dhe shkrim kreativ.

Punoni, udhëtoni, qëndroni produktiv

Prishtina po shndërrohet në një mikpritëse të re për nomadët digjitalë dhe profesionistët në lëvizje. Me energji rinore dhe gjithnjë e më shumë hapësira pune, qyteti ju jep mundësinë të mos e ndalni punën edhe kur jeni larg zyrës suaj.

PRISHTINA

RENT A CAR

Shijo Pushimet Tuaja

Me veturat e modeleve të fundit!



Skeno > Shkarko > Rezervo > Zbritje përfito



+38344240383



rentacar-prishtina.com



Shoqëruesi yt në çdo udhëtim

Në një botë ku gjithçka lëviz shpejt, ka pak gjëra që mbetin të njëjtat – si freskia natyrore e Miros. Ky ujë mineral natyral buron nga zemra e tokës së Kosovës, i filtruar në mënyrë të natyrshme përmes gurit kuarc, duke ruajtur një përbërje të pasur me kalcium, magnez dhe silikate.

S'ka rëndësi ku po shkon – rëndësi ka si ndihesh gjatë udhëtimit. Në aeroplan, mbi re, larg rutinës, Miros

është përkujdesja që merr me vete. Sepse nuk është thjesht ujë – është përzgjedhje. Është stil jetese. Është një mënyrë për të thënë “unë kujdesem për veten”.

Miros është për ata që përqendrohen në detajet që kanë vlerë – të natyrshme, të pastra, të vërteta. Në çdo gllënjë, ndjen pak nga toka jonë, pak nga kujdesi ynë, dhe shumë nga ajo që meriton ti.



SkyShop Coffee&Tea



3 in 1 Nescafe Stick 20g
2 in 1 Nescafe Stick 20g
Nescafe Classic Stick 20g

2.50€

LOYD
Forest Fruit Tea Bag
Mint-Tea Bag
Camomile-Tea Bag

2.50€



SkyShop Soft Drinks

Coca Cola 0.33l
Coca Cola ZERO 0.33l
Fanta Orange 0.33l
Fanta Exotic 0.33l
Schweppes 0.33l
Schweppes Tonic 0.33l
Sprite 0.33l
Multi Sola 0.5l
Ice Tea 0.33l



3.00€



Red Bull 250ml **4.00€**
Ruko Power ml **2.50€**
GO+ 250ml **2.50€**
Veroni Active **3.00€**



RC Cola 0.33l
2.50€

Malyral Water Miras 0.5l
Sparkling Water Miras 0.33l

2.50€

Capri Sun 0.33l

3.00€

Capri Sun 0.20l

2.50€

Jaffa 0.25l

2.50€



SkyShop

Alcoholic Beverages

Ballantines Finest 0.05l
Absolut Vodka 0.05l
Chivas Regal 0.05l
Beefeater Gin 0.05l
Jack Daniel's 0.05l
Jägermeister 0.05l

5.00€



Cabernet Sauvignon 187ml
Chardonnay 187ml

5.00€

Peja Hellnes 0.5l
Peja Welzer 0.5l
Peja Pilsner 0.5l
Heineken 0.33l

4.00€



SkyShop Snacks



Skittles
m&m's 2.00€



Kinder Chocolate 50g
Kinder Joy 20g

2.00€



Bake Rolls 80g
Milka 80g

2.50€




Pringles Chips 40g

3.00€



Eti Crax
Sedefi Hey
Stobi Flips

2.00€



Haribo

3.00€



Biskota Sempre

2.50€



Vipa Chips
Classic Mix
Crunch
Apple chips

2.50€



Oreo 154g
Snickers 51g
Mars Bar 51g

Bounty Bar 51g
Twix Bar 51g
Kinder Bueno 43g
Kit Kat 42g

2.50€

SkyShop Snacks



Musli
Pop Kek 45g

2.00€



7Days Croissant Double 60g
7Days Croissant Cacao 60g

2.50€



SkyShop Meals

Soba Cup Noodles

5.00€



200g
Cheese Sandwich
Sanduiq me djath

5.00€

200g
Dried Beef meat Sandwich
Sanduiq me përshutë viçi

5.00€



SkyShop Cigarette



Smoking
kills

MARLBORO GOLD 

29.00€

MARLBORO RED 

29.00€



Smoking
kills



Winston BLUE 

24.00€

Smoking kills

Camel FILTERS 

25.00€



Smoking kills



Smoking
kills

MARLBORO TOUCH 

24.00€



Terea Amber 

23.00€

This tobacco product damages
your health and is addictive

35 VJET VEPRIMTARI ARSIMORE, KULTURORE E PATRIOTIKE TË KËSHILLIT TË ARSIMTARËVE SHQIPTARË “NAIM FRASHËRI” NË GJERMANI

Shkruan: Rifat Hamiti

Si mësues i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare për nxënësit shqiptarë në Gjermani, si bashkëthemelues i Këshillit të Arsimitarëve Shqiptarë 'Naim Frashëri' në Gjermani (1990) dhe si ish-kryetar në 3 mandate (ndërkaq prej vitit 2017 në pension), kam nderin, kënaqësinë dhe krenarinë t'ju sjell në mendje një pasqyrë të shkurtër të punës dhe të veprimtarisë së këtij këshilli, i cili vitin që lamë pas shënoi plot 35 vjet jete e pune.

Prënjë e këtij këshilli të çojnë te vitet 89-90, të cilat u karakterizuan me dhunë e aparteid të Serbisë dhe të satelitëve të saj në Kosovë e trojet e tjera etnike shqiptare në ish-Jugosllavi, në një anë, dhe të rezistencës e qëndresës shqiptare për mbijetesë e çlirim nga kjo zgjedhje barbare, në anën tjetër.

Janë vitet kur ndryshimet

kushtetuese të bëra nën forcën e armës serbe suprimuan autonominë e Kosovës, që rrjedhimisht i hapën rrugën segregacionit të paparë ndaj shqiptarëve, veprimeve shtetërore serbe për mbylljen e shkollës shqipe dhe të shkatërrimit të sistemit arsimor në gjuhën shqipe, u pushtua dhe u mbyll Radiotelevizioni i Kosovës, u pushuan nga puna pothuaj të gjithë punëtorët shqiptarë, u helmuan mbi 7000 nxënës/e shqiptarë/e e plot veprime të tjera represive e diskriminuese. Natyrshëm që me këto masa shqiptarët nuk po pajtoheshin në asnjë mënyrë. Ata, që në krye të herës, zgjodhën formë të ndryshme të rezistencës, të organizimit dhe të unitetit, ndër të cilat ishte edhe ndërtimi i një sistemi të pavarur arsimor.

Sigurisht që të gjitha këto rrethana e lëvizje patën ndikimin e tyre edhe në jetën e mërgimtarëve, të cilët me



interesim, brengë e dhembje të dyfishtë po i përjetonin këto dhe njëkohësisht po i shtonin aktivitetet e tyre ekonomike, kulturore, arsimore e politike në ndihmë të atdheut.



Në mërgatën shqiptare në Gjermani dhe jo vetëm, ndër veprimet e para të riorganizimit arsimor, kulturor e politik, ishte shkëputja përfundimtare e Shkollës Shqipe nga tutela e asaj që atëbotë quhej mësimi plotësues jugosllav, e që realisht u referohej përfaqësive diplomatike-konsullore të ish-Jugosllavisë, sipas marrëveshjeve ndërshtetërore Jugosllavi-Gjermani, përfaqësi të cilat në të vërtetë tashmë po identifikoheshin me politikat hegjemoniste të Serbisë.

Në rrethet e mësuesve shqiptarë në Gjermani po diskutohej me të madhe për një organizim që në fund do të rezultonte me pavarësimin e plotë të mësimi plotësues (Shkollës Shqipe) nga ajo jugosllave, duke u koordinuar paralelisht edhe me fitimin e mirëkuptimit të duhur dhe miratimit nga pala gjermane.

Është koha kur fillimisht në një rreth më të ngushtë mësuesish të landit NRW (unë, Rifat Hamiti, Sami Thaqi e Sejdi Gashi) e më pas duke u zgjeruar vazhdimisht edhe ndër qarqet e tjera të mësuesve shqiptarë, pothuaj në gjithë Gjermaninë, tashmë po bisedohej me të madhe e po kërkoheshin forma e modele konkrete të organizimit, të koordinimit e të mbështetjes së mësimi plotësues në gjuhën shqipe në Gjermani në nivel kombëtar. Pas takimesh e bisedash të shumta e me përmbajtje konkrete, kryesisht në banesën e Sami Thaqit, unë,

Samiu e Sejdiu e zgjeruam e intensifikuam diskutimin edhe me kolegë e kolege të tjerë/a, kështu që më 14 shtator 1990 u takuam në Remscheid, qytet ky ku Samiu mbante mësim. Në mbledhje morën pjesë pothuajse shumica e mësuesve/eve shqiptarë/e dhe vendosëm të themelojmë Këshillin e Arsimitarëve Shqiptarë „Naim Frashëri“ për Gjermani. Kjo datë realisht shënon pavarësimin e Shkollës Shqipe nga sistemi dhe mësimi plotësues i deriatëhershëm jugosllav.

KASH-i gjatë gjithë veprimtarisë së vet 35-vjeçare, herë më shumë e herë paksa më zbehtë, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në rrjedhën, cilësinë dhe aktivitetet përcjellëse të Shkollës Shqipe në Gjermani. Rëndësia e themelimit dhe e funksionimit të KASH-it ishte shumëdimensionale; mbi të gjitha u bë pavarësimi i Shkollës Shqipe, u shtua e u forcua besimi (në një kohë paksa i luhatur) i prindërve për kuadrin mësimor, u zgjerua dukshëm rrjeti i shkollave dhe ndodhi shtimi i dukshëm i numrit të nxënësve që po ndiqnin mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, menjëherë bëmë një përzgjedhje të kujdesshme të përmbajtjeve programore në frymë kombëtare, shoqëruar edhe me udhëzime shtesë për mjete e tekste mësimore, hartuam plan-programin e parë mësimor, u hartuan tekste e materiale të shumta mësimore, u hartuan dhe u botuan dy monografi

që përjetësuan edhe në letër veprimtaritë e Shkollës dhe të Këshillit, u organizuan takime e seminare aftësimi profesional, zhvilluam më tej katalogun e veprimtarive jashtëmësimore shumë të rëndësishme (kampionatet e ditorisë, takimet sportive, takimet kulturore, ekskursionet mësimore në atdhe etj.).

Ky këshill që nga fillimi ishte pranuar si legjitim nga Qeveria e Kosovës (në ekzil) dhe deri në ditët tona do të jetë referenca e parë e bashkëpunimit të institucioneve të Atdheut me Shkollën Shqipe në Gjermani. Po ashtu, roli i tij koordinues e ndërmjetësues shtrihej edhe në linjat e përfaqësimit dhe të bashkëpunimit me autoritetet shtetërore arsimore dhe të tjera gjermane (prej atyre federale e deri te drejtoritë e shkollave përkatëse).

Sot, duke kujtuar këtë datë dhe këtë kthesë të madhe në pavarësimin e Shkollës Shqipe në Gjermani, besoj se kolegët, që aktualisht janë aktive/ë, do ta mbajnë gjallë këtë institucion dhe do të angazhohen maksimalisht për ta begatuar aktivitetin e tyre me përmbajtje të reja e bashkëkohore. Po ashtu, edhe dy shtetet shqiptare do ta thellojnë e zhvillojnë më tej mbështetjen në përputhje me nevojat reale të Shkollës Shqipe në Gjermani dhe gjithandëj nëpër diasporat shqiptare.





FOTO: GÖRAN TOMASHEVIQ



FOTO: BESNIK MEHMETI

REPORTING HOUSE 2

PROJEKTI QË KTHEN MEMORIEN

Në mes të muajit mars dhe qershorit 1999, mijëra njerëz u dëbuan nga zona e Prishtinës duke u transportuar me trena, të cilët në kohën e Jugosllavisë ishin përdorur për bartjen e kafshëve.

E njohur si hapësira e stacionit të trenit, zona afër Dragodanit në Prishtinë shërbente si vend grumbullimi për refugjatët, të cilët pas disa orësh pritje hipnin në trenin e ngadalshëm dhe vazhdonin udhëtimin drejt Maqedonisë.

Fotografitë e rralla të këtyre trenave ngjajnë me pamje nga Lufta e Dytë Botërore, ndërsa kjo ngjarje do të ri-sillet përmes muzeut Reporting House 2.



FOTO: KALLXO.COM

Pak metra nga shinat ku qarkullonte treni, në fillim të janarit 2026 është vendosur një vagon kafshësh – një nga ata që bartën refugjatët. Hapësira unike e muzeut do të përdoret për të shfaqur rrëfimet e refugjatëve që përjetuan dëbimin.

Nisma për ndërtimin e muzeut në vagonin e trenit është

ndërmarrë nga producentja e muzeut, gazetarja Jeta Xharra, dhe kuratori Gazmend Ejupi.

“E dimë që ky është momenti i fundit për të dokumentuar këtë tragjedi dhe, për këtë arsye, kemi vendosur ta sjellim vagonin dhe t’i intervistojmë refugjatët që udhëtuan të paketuara si sardina në trenat e kafshëve”, thotë Xharra.

Gazmend Ejupi shpjegon pse e përzgjedhi një vagon të shtazëve dhe mallrave për ta shndërruar në muze të ruajtjes së kujtesës kolektive.

“Gjatë hulumtimit që bëmë, takuam njerëz që na treguan se, pasi që të gjithë vagonët e udhëtarëve u shfrytëzuan për të bartur refugjatë, forcat serbe i përdorën vagonët e kafshëve dhe të mallrave për t’i transportuar njerëzit. Kjo më la shumë përshtypje dhe filluam të kërkojmë vagonin që na e përshkruan refugjatët”, shpjegon Ejupi.

Pjesa thelbësore e nismës është dokumentimi i ngjarjes përmes intervistave. Nga muaji gusht 2025 deri në muajin janar 2026, gazetarja Xharra ka mbledhur mbi 30 rrëfime të qytetarëve të ndryshëm që e përjetuan këtë tragjedi.



FOTO: KALLXO.COM



FOTO: KALLXO.COM

Në mesin e të intervistuarve është edhe Sherife Luta nga Kaçaniku, gruaja që u bë simbol i

vuajtjes së dëbimit të shqiptarëve në Kosovë. Ajo u fotografua gjatë rrugëtimit drejt Maqedonisë me



FOTO: KALLXO.COM

TË INTERESUARIT PËR TA MBËSHTETUR MUZEUN MUND TË MARRIN INFORMACIONE NË NUMRIN E TELE FONIT +383 44 231 998 OSE TË JAPIN DONACIONE ONLINE NË XHIROLLOGARI:

BENEFICIARY NAME: RRJETI BALLKANIK I GAZETARISE HULUMTUESE
BENEFICIARY ADDRESS: MENSA E STUDENTËVE, KATI I PARË, PRISHTINA, 10000, REPUBLIC OF KOSOVA
BENEFICIARY BANK: TEB J.S.C.
BENEFICIARY BANK ADDRESS: MBRETËRESHA TEUTA, PRISHTINA, REPUBLIC OF KOSOVA
ACCOUNT NUMBER / IBAN: XK05-2032-0002-5556-3435
SWIFT CODE: TEBKXKPR



FOTO: BESNIK MEHMETI

vetëm me marrë vesh populli ynë, por me marrë vesh e gjithë bota", tha Luta.

Deri më tash, ekipi i KALLXO.com, i udhëhequr nga producenti Faton Ibrahim, ka realizuar 30 intervista me qytetarë që janë dëbuar n

ga qytete të ndryshme të Kosovës.

"Ky është vetëm fillimi. Sivjet po bëjmë thirrje që të na lajmërohen qytetarë të tjerë, sepse në të kaluarën shekullore, kur është dëbuar popullata jonë, nuk kemi pasur kamera. Tash kemi ekipe të përgatitura dhe do t'i vëmë të gjitha veglat tona mediatike në shërbim të dokumentimit të kësaj përvoje, sepse e kemi obligim ndaj gjeneratave të ardhshme", tha Ibrahim.

Muzeu është në fazën e fundit të përgatitjeve dhe pritet të nisë punën në muajt e parë të vitit 2026.

Nisma është mbështetur nga institucione publike, përfshirë Infrakos-in, si dhe nga disa kompani private, si Lim Projekt, Migjeni Sigma dhe partnerë të tjerë. Nisma e muzeut Reporting House nisi në vitin 2025, duke krijuar në Prishtinë muzeun më të vizituar të luftës. Qendra kryesore e muzeut ndodhet në qendër të Prishtinës, në ndërtesën e Gërmisë, ku tashmë janë grumbulluar mijëra materiale të dokumentimit të rezistencës dhe luftës.

Muzeu vizitohet pa pagesë pesë ditë në javë, nga e marta deri të shtunën, nga ora 10:00.

Për ta mbështetur muzeun është krijuar një nismë e mbështetësve, të cilët përmes donacioneve online apo donacioneve direkte mund ta ndihmojnë këtë projekt.



FOTO: KALLXO.COM

beben e saj në gji nga fotografi boshnjak Damir Šagolj.

"Unë s'pritoj me kallëzu për këtë

vend se çfarë ka vuajtur Kosova.

Për atë kam ardhur dhe s'pritoj

kurrë, sepse duhet me i kallëzu, jo

DESIGN

REKLAMA 3D

DIGITAL PRINT

ADVERTISING

MATERIALE
PROMOCIONALE

BRANDING

LED SCREEN

Be Only Premium



+383 (0)38 60 60 68
+383 (0)45 87 87 87
+383 (0)45 97 97 97

Highway Prishtina - Shkup 6-th km
10000 Prishtinë, Kosovë
info@zhakiadvertising.com
www.zhakiadvertising.com



SHOQËRIMI I FËMIJËS SHQIPTAR NË DIASPORË ME TË TJERËT DHE ROLI I PRINDIT

Shkruan: Nuhi Gashi

1. Përtej izolimit e drejt integritimit

Sot shqiptarët, si një komb mjerisht me mbi gjysmën e vetvetes jashtë hapësirës së njohur si etnikisht shqiptare (sikur tashmë është krijuar një 'Shqipëri e dytë'), gjithnjë e më tepër ballafaqohen me probleme serioze të qenësisë së tyre identitare; të ruajtjes dhe kultivimit të kësaj qenësie deri në krenari e vetëdije të prejardhjes (etnicitet), të perspektivës së garantimit të kësaj qenësie në parametrat e saj themelore (gjuhë amtare, kulturë kombëtare etj.). Dhe, pa dyshim,

janë fëmijët apo moshat më të reja të cilat, në ballafaqim apo në rrethanat e ndërveprimit me realitetet e jetës dy e më shumë gjuhësore e kulturore me shtrirje në të gjitha sferat e jetës, ndeshen me probleme të edukimit themelor e të mirëfilltë identitar si shqiptar. Si gjithnjë, janë prindërit faktori kyç që përckaton fatin identitar të fëmijës.

Në kushte e ambiente të ndryshme e deri në më të mirat, ata (prindërit) ndërgjegjshëm, gjithnjë edhe me angazhimin e tyre ku më shumë e ku më pak, kërkojnë, gjejnë, kontribuojnë në institucionin e shkollës; të

shkollës së rregullt të vendit pritës dhe të asaj tjetrës, që e quajmë Shkollë Shqipe, të shkollës tjetër plotësuese, të mësimi të gjuhës amtare dhe të kulturës kombëtare. Fundja, a nuk është shkolla mjedisi më i organizuar e më i sistemuar ku, ndër të tjera, fëmijëve u ofron mundësinë e shoqërimit e njohjes së ndërsjellë.

Nga do që ta marrësh, kjo njohje e ky shoqërim përbën një masë serioze preventive ndaj izolimit dhe pasojave të tij. Fëmijët që ndjekin mësimin plotësues në gjuhën amtare paraprakisht do të jenë më të përgatitur në të gjitha rrafshet për një shoqërim e

komunikim me të tjerët në jetën e përditshme, por mjerisht në rastin tonë (shqiptar) pjesëmarrja në këtë rrafsh (në Shkollën Shqipe në Diasporë) është më pak se simbolike. Kështu që, përsëri barra themelore do t'i përketë familjes-prindit. Nëse shoqërimi nënkupton para së gjithash zhvillim të ekuilibruar e të shëndetshëm intelektual, emocional e shoqëror, kjo i bie që ata do të jenë shumë më të përgatitur dhe në role subjekti (me të drejta e detyra dhe me përgjegjësi për to) në rrjedhat e integritetit të mirëfilltë e të barabartë në shoqërinë e vendit pritës. Pra, shumë më afër integritetit e larg e më larg të keqes së madhe që iu rri te koka si shpatë Demokleu-asimilimit.

Lidhja, shoqërimi e komunikimi me të tjerët, si në shkollë, si në lojë, si në jetën e përditshme (reale e virtuale) nënkupton edhe një urë të sigurt kah ndërveprimi i gjallë me bashkëmoshtarët dhe evitimin e komplekseve dhe të frikërave nga humbja e rrënjëve, identitetit të prejardhjes.

Fakti, ku shoqërimi me të tjerët në jetën e përditshme jo vetëm i fëmijëve shqiptarë për arsye të ndryshme lë shumë për të dëshiruar, nxjerr në dritë edhe profilet dhe kahet e zhvillimit të shoqërive të caktuara, të cilat tashmë jo rrallë po manifestojnë sinjale të mosdurimit, mospranimit dhe të sjelljeve ksenofobe. Prandaj ky realitet për prindin e ndërgjegjshëm vërtet përbën një sfidë të vërtetë. E sfida duhet mposhtur, respektivisht edukimi i fëmijës për një shoqërim normal, pa komplekse, me dinjitet e krenari të prejardhjes (por, pse jo edhe të identitetit të dyfishtë) duhet të thellohet. Fundja këta fëmijë janë dypatridë dhe është detyrë jo vetëm e

prindit që të sigurojë rrethana e kushte normale të zhvillimit të këtij identiteti të dyfishtë (si një pasuri personale e kolektive), që në shkollë është përkufizuar shumë qartë brenda dy parimeve themelore; të interesit kombëtar dhe të ndërkulturoresisë.

2. Përparësitë e shoqërimin

Sot, studimet krahasimtare ndërdisiplinare i mësojnë me të madhe pikëpamjes së domosdosë së krijimit të kushteve e të rrethanave për një shëqërim sa më dinamik e me sa më shumë përmbajtje të fëmijëve në shoqëri e ambiente dy e më shumë gjuhësore e kulturore. Ne të gjithë e dimë se sot mbi gjysma e fëmijëve shqiptarë në botë jetojnë, shkollohen e zhvillohen në shoqëri e ambiente të tilla. Bile, për fatin tonë të mirë, mërgata shqiptare e kohës sonë është e përqëndruar kryesisht në hapësirat ekonomike dhe kulturore më të zhvilluara e më të emancipuara të planetit tonë dhe këtë duhet trajtuar me shumë kujdes nga të gjithë subjektet e rëndësishme të edukimit të fëmijëve.

Ndoshta këtu duhet qortuar, nëse jo mungesën e plotë, gjithsesi pamjaftueshmërinë në përputhje me nevojat reale kulturore e arsimore të mërgatës të kompetencës shtetërore të shteteve shqiptare (sic!). Së këndjemi, përkundër kësaj, ti si prind që je (mjerisht jo mjaftueshëm i përkrahur nga faktorë të tjerë), që në krye të herës, duhet të jesh i ndërgjegjshëm për përparësitë që ofron ky shoqërim dhe të jesh gati të ndihmosh në të gjitha fushat dhe me të gjitha mjetet e mundshme. Pse, thua ti? Sepse fëmija yt do të përfitojë në shumë rrafshë shumë të rëndësishme të

zhvillimit të tij, ndër të cilat po i veçoj:

a) Në rrafshin e zhvillimit emocional dhe social ose thënë më shkoqur, i shoqëruar me të tjerët, ai do t'i besojë me tepër vetes, do të jetë më krenar me përkatësinë e tij burimore (si shqiptar), do të zhvillojë brenda vetes ndjenjën e empatisë, do të kultivojë një frymë më dinamike bashkëpunimi e ndërveprimi me tjetrin, do të jetë më i hapur, larg kurthit të të qenit i vetmuar, i përjashtuar apo i izoluar etj.

b) Ai, brenda asaj që e quajmë integritet, do të ketë përgatitjen e duhur për përshtatje me normat, rregullat, sjelljen e kulturën e vendit pritës, kështu që sigurisht do të ndjehet i barabartë me të tjerët e të gjitha këto do të kenë ndikimin e duhur pozitiv edhe në shkollë (me shoqet e shokët, me mësuesit e të tjerët në mësim e në veprimtari të ndryshme shkollore), në lojë e veprimtari të ndryshme shoqërore e publike, gjithnjë pa e rrezikuar apo humbur identitetin e tij burimor si shqiptar .

c) Duke qenë i shoqëruar e pa komplekse me të tjerët, ai do të arrijë të mësojë natyrshëm e njësoj si të tjerët gjuhën e vendit, kështu që, në shumicën e rasteve në përputhje edhe me statusin e tij juridik, nuk do të ketë vështirësi komunikimi as në shkollë e as në jetën shoqërore.

BRETKOSA E ZGJUAR



Nga të gjitha bretkosat që jetonin në pellgun në pyll, Tomi ishte më i zgjuari.

Ai mund të fliste për orë të tëra për yjet në qiell, për mënyrën se si rriteshin bimët, ose për jetën e poetëve dhe mbretërve të mëdhenj.

Ai kishte, gjithashtu, një fjalor shumë të madh! "Tomi dinte kaq shumë fjalë të bukura sa ndonjëherë nuk mund ta kuptoje se çfarë do të thotë!", tha fqinji i tij. "Kaq shumë i zgjuar është".

Tomi ishte një bretkosë shumë miqësore dhe e sjellshme, por ai ishte gjithashtu krenar që ishte më i zgjuari në pellg.

Kjo ishte arsyeja pse ai kurrë nuk e kërkoi këshillën e askujt dhe nuk u interesua për mendimet e tyre! Një ditë, ai vendosi të shkonte në pyll për të lexuar.

"Dua të përfundoj librin tim dhe është e vështirë të përqendrohem këtu, për shkak të të gjitha kërcitjeve!", tha me vete. Kështu, ai hipi në pyll dhe gjeti një karrige të bukur për të lexuar.

Megjithatë, pasi lexoi për disa orë, Tomi u ndie i shqetësuar. "Unë mund të shëtis përreth për pak!", tha ai. "Do të marr rrugën e gjatë për në pellg, kush e di se çfarë do të gjej gjatë rrugës."

Ai u largua nga shtegu i pyllit, por nuk kaloi shumë kohë dhe ai kishte humbur rrugën. "A e kam kaluar më parë atë pemë?", mendoi ai. "Isha i sigurt se pellgu im ishte këtu!" Pikërisht atëherë, një urith nxori kokën nga toka.

"Oh, përshëndetje Tomi!", tha urithi. "Ju jeni shumë larg nga pellgu, keni nevojë për udhëzime?"

Tomi nuk donte që askush të

mendonte se dikush aq i zgjuar sa ai do të kishte nevojë për ndihmë.

"Oh jo, jam mirë!", i tha urithit para se të largohej me nxitim. Tashmë ishte bërë shumë errësirë. A do të ishte në gjendje Tomi të kthehej në shtëpi para se të bjerë nata?

Ai dëgjoi një britmë të fortë. Ishte një zhabë e vjetër, i cila po e vështronte.

"Çfarë bën një bretkosë e vogël si ti në pyll në këtë kohë të natës? Dëshironi udhëzime?", tha zhaba.

Por Tomi ende ndihej shumë krenar dhe i turpëruar për të pranuar se kishte humbur.

"Oh jo, unë jam ... duke parë yjet!", mermëriti ndërsa po largohej me nxitim.

"Si mund t'i shikosh yjet në një pyll me kaq shumë pemë?", u habit zhaba. "Çfarë bretkose budallaqe!"

Tani ishte vërtet errësirë dhe Tomi kishte humbur të gjithë ndjenjën e orientimit. Në errësirë nuk mund të shihte asnjë pikë referimi për ta udhëhequr.

"Si do të jem në gjendje të gjej rrugën time për në shtëpi tani?", mendoi me vete duke u ndjerë i mjerë.

Ai do të donte që të mos ishte aq krenar për zgjuarsinë e tij dhe në vend të kësaj të kishte kërkuar ndihmë. "Ndoshta dikush do të vijë dhe do të më ndihmojë", bërtiti ai me shpresë.

Por pylli ishte i errët dhe i heshtur. Asnjë kafshë e vetme nuk erdhi dhe bretkosa e zgjuar duhej të kalonte një natë të lagësht dhe të ftohtë duke u dridhur nën një kerpudhë.

Tomi vendosi që, tani e tutje, ai nuk do të ishte shumë krenar për të kërkuar këshilla. "Nëse do të isha vërtet i zgjuar, do t'i kisha dëgjuar të tjerët!", mendoi ai.



KAMELEONI
SISTEME ALUMINI

“Ndreqe terasen ftofja kojshisë”



+383 49 800 020
www.kameleoni.biz
info@kameleoni.biz

📍 Kameleoni SHPK 📷 [kameleoni.llc](https://www.instagram.com/kameleoni.llc)

Rruga e pejë nr 460, Miradi e epërme 12000 Fushë Kosovë



ECJET E GJATA LIDHEN ME PËRMIRËSIMIN E SHËNDETIT TË ZEMRËS DHE JETËGJATËSINË

Keni dëgjuar ndonjëherë dikë të thotë se i pëlqejnë ecjet e gjata në plazh? Nëse po, ata mund të kenë zbuluar një nga sekretet e shumë përfitimeve për jetëgjatësinë.

Të rriturit që ecin për periudha më të gjata, të cilat studiuesit i kanë përcaktuar si më shumë se 10 minuta, kishin rrezikë dukshëm më të ulëta për sëmundje kardiovaskulare dhe vdekje të parakohshme, krahasuar me ata që ecin për periudha më të shkurtra, sipas një studimi të botuar të hënën në revistën *Annals of Internal Medicine*.

"Shumica e studimeve fokusohen te numri total i hapave ditorë (përfshirë studimet tona të mëparshme), por studimi ynë tregon se mënyra se si i akumuloni ato hapa ka rëndësi gjithashtu - veçanërisht për individët më pak aktivë", tha dr. Borja del Pozo Cruz, autori i parë i studimit. "Kjo shton nuanca deri '10,000 hapa në ditë': edhe nëse nuk arrini këtë numër, disa ecje më të gjata në vend të shumë hapave të shkurtër e të shpërndarë mund të bëjnë një ndryshim të madh për shëndetin e zemrës dhe jetëgjatësinë."

Rreth 31% e popullsisë së rritur në botë janë fizikisht joaktive dhe nuk arrijnë rekomandimin global për të kryer të paktën 150 minuta ushtrime në javë.

Stili i jetesës sedentare lidhet me një rrezik më të lartë për pagjumësi, mortalitet dhe sëmundje kardiovaskulare.

"Të gjithë mund të përfitojnë nga ecja - nuk ka grup për të cilin ecja të jetë e dëmshme. Por këto gjetje janë veçanërisht relevante për njerëzit që janë sedentarë ose që bëjnë më pak se rreth 8,000 hapa në ditë", tha del Pozo Cruz, profesor i asociuar dhe studiues i lartë në Fakultetin e Mjekësisë, Shëndetit dhe Sportit, 'Universidad Europea de Madrid', Spanjë.

Nuk ka rrugë të shkurtra drejt shëndetit

Ndërtimi i aftësisë për të ecur për periudha më të gjata mund të ndihmojë për përmirësimin e shëndetit kardiovaskular dhe forcës së zemrës.

"Shumica e njerëzve mund të ecin për një, dy ose pesë minuta pa problem. Por kur fillon të arrish ... 20, 30,

40 ose 60 minuta, bëhet shumë më e vështirë dhe kjo është aftësia që ne po përpiqemi të zhvillojmë", tha dr. Andrew Freeman, drejtor i parandalimit dhe mirëqenies kardiovaskulare në National Jewish Health, Denver.

Ushtrimet e rregullta trajnojnë muskujt për të nxjerrë oksigjen nga gjaku, duke ulur ritmin e zemrës, inflamacionin dhe stresin.

"Ecjet më të gjata ndihmojnë për përmirësimin e qarkullimit të gjakut, uljen e presionit të gjakut dhe mbështetjen e kontrollit të glukozës - të gjitha këto janë çelësi për shëndetin e zemrës", tha del Pozo Cruz.

Ato, gjithashtu, mund të rrisin volumetrinë e stimulimit të zemrës, që është e nevojshme për të aktivizuar dhe angazhuar plotësisht muskujt.

Por, si shumica e muskujve në trup, ushtrimi për periudha më të gjata nuk është diçka që mund ta bëni menjëherë.

"Mund ta mendoni një ecje të gjatë si ngritjen e një peshe prej 45 kilogramësh", tha Freeman. "Nuk mund të shkoja thjesht dhe ta bëja menjëherë. Duhet të ndërtoja kapacitetin, të forcoja muskujt për të arritur atje. E njëjta gjë vlen për forcën e zemrës dhe për kardiorenimin."

Shumë herë dëgjojmë njerëz që thonë të arrijmë një objektiv të caktuar: 10,000 hapa në ditë ose 150 minuta ushtrime në javë. Por kjo mund të jetë e vështirë për t'u ndjekur dhe e mbingarkuar, veçanërisht për ata që nuk jetojnë një jetë shumë aktive.

Prandaj ky studim fokusohet te kohëzgjatja, ose sa gjatë ecni.

"Shpejtësia ende ka rëndësi, por kohëzgjatja dhe qëndrueshmëria e ecjeve duket se janë faktorë të fuqishëm. Pra, në vend që të numërosh çdo hap, njerëzit mund të fokusohen në seanca të shkurtra ecjeje të pandërprerë gjatë ditës", tha del Pozo Cruz.

Ndërtimi i forcës së zemrës

Konsistenca është çelësi. Përfshirja e ushtrimeve të thjeshta, si ecja në rutinën tuaj të përditshme, do të ndërtojë qëndrueshmëri dhe do të rrisë kapacitetin fizik.

Metoda më e lehtë është ecja, duke ndjekur formën e mirë: qëndroni drejt, me shpatullat mbrapa dhe tundni krahët, gjë që ndihmon për të parandaluar dhimbjet e shpinës, për të thithur lehtësisht ajrin dhe për të ruajtur ekuilibrin.

"Ecja është një lëvizje e tërë trupit. Nuk është vetëm për këmbët", tha Dana Santas, specialiste e certifikuar e forcës dhe kondicionimit dhe trajner në sportet profesionale.

Për fillestarët, mund të rrisni kohëzgjatjen e ecjeve duke parkuar më larg vendit të zakonshëm ose duke praktikuar "kardio të rehatshme".

"Objektivi mbetet rreth 30 minuta aktivitet fizik që merr frymë, që është një nivel i fortë për shumicën e njerëzve", tha Freeman.

Aktiviteti fizik që merr frymë do të thotë të ecësh me ritëm të shpejtë ku mund të flasësh, por jo të këndosh.

Ushtrime të tjera të mira për zemrën përfshijnë qëndrime kundër murit, plank, ose lëvizje aerobike si ciklizmi.

Ndërtimi i kapacitetit për lëvizje më të gjata është thelbësor, sepse "duhet rezerva kardiake, forcë kardiake dhe, sigurisht, forcë fizike. Të gjitha së bashku janë parandalues të jashtëzakonshëm për shumë sëmundje të zemrës, përfshirë sëmundjen koronare dhe hipertensionin", tha Freeman.



KU DHE SI MUND TË ANKOHEMI PËR FATURAT?

Qytetarët e Kosovës, përfshirë edhe ata që jetojnë në diasporë, por marrin shërbime në vend, kanë të drejtë të ankohen kur mendojnë se faturat që i pranojnë nuk janë të sakta apo nuk e pasqyrojnë shërbimin e ofruar. Në secilin shërbim lokal apo komunal autoritetet e kanë paraparë të drejtën e qytetarëve për t'i kontestuar faturat dhe për të kërkuar të drejtën e tyre. Në vijim është paraqitur një listë me autoritetet për të cilat mund të paraqiten ankesa.



Ankesat për faturat e energjisë elektrike

Në rast të pakënaqësisë me faturat e energjisë elektrike, ankesa e parë duhet të drejtohet te kompania furnizuese, KEDS. Nëse ankesa nuk zgjidhet në këtë nivel, qytetarët mund t'i drejtohen Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRRE). Autoriteti mbikëqyrës, në rast të shkeljeve të konstatuara, ka të drejtë të obligojë kompaninë që t'ua kthejë qytetarëve mjetet e paguara padrejtësisht.

Ankesat për faturat e ujit

Për faturat e ujit, ankesa e parë duhet të bëhet pranë ndërmarrjes së ujësjellësit përkatës. Nëse çështja nuk zgjidhet, ankesa mund të dërgohet në Autoritetin e Ujërave të Kosovës. Ky autoritet, pas shqyrtimit të rastit, mund ta detyrojë ndërmarrjen që t'i kompensojë qytetarët, duke kthyer mjetet e paguara pa bazë.



Ankesat për faturat e tatimit në pronë

Sa u përket faturave të tatimit në pronë, ankesat parashtrohen në Drejtorinë e Pronës në komunën kompetente. Në rast se konstatohet gabimi në vlerësim apo faturim, autoriteti komunal mund të marrë vendim për korrigjimin e faturës dhe kthimin e mjeteve të paguara më tepër.

Ky proces u jep qytetarëve mundësinë të kërkojnë drejtësi dhe transparencë, duke siguruar që pagesat të jenë të drejta dhe të bazuara në ligj.



- **Sistemi i kamerave (CCTV)**
- **Alarmi kundër vjedhjes dhe zjarrit**
(Intruder & Fire alarms)
- **Kontroll i qasjes (Access control)**
- **Menaxhimi i orarit të punës**
(Time & Attendance systems)
- **Instalime të infrastrukturës LAN**
(LAN infrastructure installation)
- **Sistemi i menaxhimit të ndërtesave**
(Building management systems - BMS)
- **Sistemi i adresimit publik**
(Public address systems)

+383 49 514 600

info@inetkosova.com

Rr. Mirjane Dragovic p.n.,
Çagllavicë, Prishtinë, Kosovë

f INET-Kosovë

@ inetkosova

in INET (Prishtina, Kosovo)



"Fuqizojmë markën tuaj. Sjellim rezultate të vërteta."

Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur,
PFP – Possibilities for Partners është partneri juaj
strategjik për rritje, vizibilitet dhe ndikim.

Na Kontaktoni Këtu!
☎ +383 43 899 331
🌐 www.pfp-ks.com ✉ info.pfp.ks@gmail.com
📍 Prishtinë, Rexhep Luci, Pristina, Kosovo



Marketing & Strategji

Fushata të personalizuara që arrijnë
audiencën tuaj ideale.



Web Design & Development

Website të dizajnuar me kujdes,
funktionale dhe të optimizuara.



Produksion Multimedial

Video profesionale, grafika kreative,
përmbajtje audio dhe vizuale për çdo
platformë.



Public Relations

Ndërtim dhe ruajtje e një imazhi pozitiv
për markën tuaj.



Marketing Dixhital

Menaxhim i rrjeteve sociale, Google Ads,
Email Marketing dhe më shumë.



Zgjidhje IT

Sisteme të personalizuara që risin
efikasitetin dhe automatizimin.

Që nga marketingu klasik dhe dixhital, e deri te prodhimi kreativ, ndërtimi i faqeve të internetit dhe zgjidhjet
inteligjente IT, ne ofrojmë zgjidhje të personalizuara për çdo biznes që synon të dallohet dhe të rritet.

Mirësevini në Hotel Bonita

NË GOLEM, KAVAJË!

DESTINACIONI IDEAL PËR PUSHIME TË PAHARRUESHME!


Hoteli me 5 yje ofron pishina të brendshme dhe të jashtme, SPA, qendër fitnesi, plazh privat dhe restorant me kuzhinë cilësore

+355 69 822 9985 | www.hotelbonita.al

Trendi modern i hotelerisë

Mirësevini në Bonita Luxury Resort!

- ✓ Akomodime luksoze
- ✓ Kuzhinë e klasit botëror
- ✓ Relaksohuni dhe rigjallërohuni



+355 69 559 9916 | www.hotelbonita.al



SHIJA E ATDHEUT *në çdo destinacion*

★★★★
MIKPITJE ME ZEMËR, ÇDO DITË!



FILLONI RRUGËN DREJT BUZËQESHJES SUAJ TË RE!



DR SPEC KIRURG ORAL DHE IMPLANTOLOG **RAGIP DÜRMISHI**

Medikadent është një klinikë dentare moderne e profesionale në ofrimin e kujdesit dentar me cilësi të lartë dhe perkushtim të madh ndaj pacientit, duke përdorur teknologji të avancuar dhe specialistë të trajnuar ndërkombëtarisht. Nga stomatologjia estetike dhe transformimet e buzëqeshjes, deri te implantet dentare dhe kujdesi i plotë oral, Medikadent kombinon precizitetin, komoditetin dhe rezultate afatgjata. E besuar nga pacientë vendas dhe ndërkombëtarë, klinika është e perkushtuar ndaj sigurisë, ekselencës dhe planeve të personalizuar të trajtimit, të dizajnuara për të rikthyer vetëbesimin — një buzëqeshje në çdo hap. Zbuloni kujdes dentar të jashtëzakonshëm dhe përjetoni ndryshimin me Medikadent.



QASJA JONË PËRCAKTOHET NGA:

• EKSELENCA ESTETIKE

Ofrimi i buzëqeshjeve natyrale përmes stomatologjisë estetike të avancuar dhe dizajnit të buzëqeshjes

• KOMODITETI I PACIENTIT

Përdorimi i teknikave moderne dhe një qasje e kujdesshme për një përvojë të qetë dhe me sa më pak dhimbje

• OFERTA SPECIALE PER IMPLANTE DENTARE AFATGJATA

Fokus në qëndrueshmëri, siguri dhe funksionalitet, duke përdorur materiale cilësore dhe planifikim profesional

• KUJDES PROFESIONAL DHE I PERSONALIZUAR

Specialistë të trajnuar ndërkombëtarisht që ofrojnë plane trajtimi të përshtatura për pacientë vendas dhe ndërkombëtarë



www.medika-dent.com



Veli Furniture

Riformoni shtëpinë tuaj

VELI Furniture ofron mobille klasike dhe moderne të dizajnuara me kujdes, duke kombinuar cilësinë me stilin. Me fokus të veçantë në shërbimin ndaj klientit, ne sigurojmë zgjidhje të personalizuar për çdo ambient të shtëpisë suaj. Zgjidhni elegancën dhe komoditetin që ju përshtatet.



+383 48 333 382
+383 46 700 400

velifurniture

velifurnitureks@gmail.com

Shupkovc, Mitrovicë | Mazgit, Prishtinë